

A white diamond shape is positioned on a vertical blue bar on the left side of the page.

# Programi i Statistikave Zyrtare

2007 - 2011

A horizontal yellow brushstroke is located below the year range.

## PROGRAMI KOMBËTAR PESËVJEÇAR I STATISTIKAVE ZYRTARE

### Përmbajtja e lëndës

#### PJESA E PARË

#### AKTIVITETET STATISTIKORE NË MBËSHTETJE TË BURIMEVE BUXHETORE AFATMESME TË MIRATUARA.

##### Hyrje

1. Kuadri ligjor i aktiviteteve statistikore që do të kryhen në periudhën 2007 – 2011

2. Objektivat kryesore të programit 2007 – 2011

3. Përmbajtja e programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare

- 3.1 Drejtimi cilësor në sistemin kombëtar të statistikave
- 3.2 Analiza SWOT
- 3.3 Klasifikimet
- 3.4 Trajnimi i statisticienëve
- 3.5 Shërbimet e teknologjisë së Informacionit dhe të Infrastrukturës
- 3.6 Politikat e shpërndarjes
- 3.7 Regjistrat
- 3.8 Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti statistikor
- 3.9 Fushat statistikore
- 3.10 Analiza sipas fushave statistikore

4. Kushtet për funksionim të sistemit statistikor kombëtar

5. Organizimi i burimeve njerëzore dhe financiare

6. Planifikimi i kostos së nevojshme për operacionet statistikore 2007-2011

7. Monitorimi i implementimit të Programit

8. Lista e Indikatorëve

#### PJESA E DYTË

#### “ PROPOZIME PËR AKTIVITETE STATISTIKORE TË REJA” QË PLOTËSOHEN NË KUSHTET E SIGURIMIT TË FONDEVE BUXHETORE SHITESË”

##### Hyrje

Detyrat kryesore deri në fund të vitit 2011

Përmirësime të statistikave makroekonomike

Regjistrime të përgjithshme

Përmirësime të statistikave parësore

Planifikimi i burimeve njerëzore dhe fondeve monetare

## Hyrje

Informacioni statistikor luan një rol të rëndësishëm në procesin e vendimarrjes, duke përmirësuar cilësinë e tij si kundrejt kohës dhe shpërbërjes gjeografike. Organizimi i këtij informacioni dhe transformimi i tij në një të mirë publike, kërkon jo vetëm ngritjen e mjeteve që mundësojnë transparencën dhe paanshmërinë e tij, por edhe të matjes së performancës së vetë sistemit. Në këtë kuadër hartimi, ndjekja dhe monitorimi i cilësisë së Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare merr një rëndësi të veçantë.

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare, që Ju paraqitet në këtë dokument, është i pari i këtij lloji që hartohet në vend mbas krijimit të Institutit të Statistikës (INSTAT) si një institucion i pavarur (1993) dhe në përputhje me ligjin 9180, datë 05.03.2004 "Për Statistikat Zyrtare".

Gjatë dekadës së fundit shumë ndryshime ndodhën në sistemin statistikor kombëtar, të cilat shprehën drejtpërsëdrejti ndryshimet që ndodhën në sistemin ekonomik dhe social të vendit. Edhe për vetë vendin kjo dekadë shënoi rritje të kontakteve me komunitetin ndërkombëtar, të cilët padyshim shtruan përpara sistemit statistikor kombëtar kërkesa të reja sidomos lidhur me **klasifikimet** dhe **metodologjitë**. Ndërsa vetë tranzicioni i sistemeve kërkoi heqjen dorë nga grumbullimi i disa llojeve të informacionit dhe zëvendësimin e tyre me informacione më të kualifikuara si dhe me metoda të reja më bashkëkohore. Gjithashtu tërësia e subjekteve statistikore u pasurua edhe me elementë të rinj, të papërdorur më parë. INSTAT gjatë kësaj periudhe është përpjekur të krijojë disa instrumenta bazë që do të shërbenin në ecurinë e vetë sistemit, si **Regjistri i Ndërmarrjeve Jobujqësore, Regjistri i Njësive Familjare Ekonomike Bujqësore, Regjistri i Zonave të Regjistrimit** për të gjithë territorin e Shqipërisë. Këto instrumenta të ngritura mirëmbahen nga INSTAT në mënyrë të vazhdueshme.

Hapja e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, kërkon medoemos edhe përmirësime të studiuara të Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare. Ndaj shtrun si domosdoshmëri përpara hartuesve të këtij programi nevojën për një vëzhgim të hollësishëm të përputhshmërisë, që sistemi ynë statistikor ka me Acquis Communautaire. Padyshim që hartimi i këtij programi udhëhiqet edhe nga kërkesa për informim mbi ecurinë e Programit të Qeverisë.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila është integruar plotësisht me Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit, kërkon që në mënyrë periodike të monitorohen grupet në nevojë dhe të përcaktohen strategjitë për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Tërësia e treguesve duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të lehtësojnë pikërisht kuptimin e këtyre dy roleve që luajnë Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit.

## 1. KUADRI LIGJOR I AKTIVITETEVE STATISTIKORE QË DO TË KRYHEN PËR PERIUDHËN 2007-2011

**Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare**, mbulon të dhënat statistikore, të nevojshme për vëzhgimin e gjëndjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fenomene thelbësore për vendimarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për informim. Për realizimin e programit mbahen parasysh marrëdhëniet ndërmjet kostove dhe përfitimeve.

**Ligji i Statistikave Zyrtare** përcakton elementet kryesore të përmbajtes së Programit që janë: treguesit, klasifikimet, nivelet e disagregimit, frekuencën, listen e burimeve të përdorura, institucionet përgjegjëse, periudhën në të cilën do të fillojnë të llogariten treguesit dhe kur do të bëhen të disponueshem për shpërndarje. Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare do të miratohet me një ligj të veçantë për një periudhë 5 vjeçare.

Afati pesë vjeçar i miratimit të Programit konsiderohet një zgjidhje që ofron përparësi kundrejt një programi njëvjeçar duke synuar vendosjen e një stabiliteti që është i rëndësishëm, sepse vlera e statistikave varet deri në njëfarë shkalle nga mbledhja e të dhënave të njëjta për disa vite me qëllim që të shqyrtohen zhvillimet. Gjithashtu miratimi i një Programi afatgjatë është në përputhje dhe me standartet europiane dhe ndërkombëtare.

**Këshilli i Statistikave**, është një nga organet drejtuese të INSTAT. Roli i këtij Këshilli është të mbikqyrë, mbështesë dhe të marrë vendime në ndihmë të INSTAT për të siguruar që Programi i Statistikave Zyrtare hartohet dhe zbatohet sipas parimeve të OKB-së.

Kompetencat e Këshillit kanë për qëllim që të mbështesin INSTAT dhe Drejtorin e Përgjithshëm për të siguruar që statistikave zyrtare janë prodhuar me një nivel të lartë profesional. Ai është përgjegjës edhe për miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së INSTAT, që lidhet me zbrëthimin në afate më të detajuara kohore të Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare. Ai është i caktuar edhe të ndjekë treguesit e performancës së INSTAT dhe të gjithë sistemit statistikor në përgjithësi.

**Marrëveshjet e Mirëkuptimit.** Për të rregulluar bashkëpunimin dhe mirëkoordinimin me Agjensitë e tjera statistikore, INSTAT mbështetur edhe në ligjin për Statistikat Zyrtare harton Memorandume Mirëkuptimi me agjensitë statistikore dhe mbajtësit e të dhënave administrative. Këto Memorandume nuk përbëjnë një risi në vetvete. INSTAT i ka përdorur ato që në vitin 1996. I pari shëmbull ka qenë Memorandumi me Ministrinë e Financave për marrjen e të dhënave për subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të Statistikave Zyrtare, INSTAT me asistencë të huaj ka hartuar disa draft-memorandumesh me disa nga agjensitë statistikore, për të maksimizuar përdorimin e burimeve të të dhënave. Në kuadrin e secilit memorandum mirëkuptimi është parashikuar ngritja e një grupi teknik me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të INSTAT dhe agjensisë statistikore, palë e memorandumit. Ky grup teknik kryesohet nga një përfaqësues i INSTAT dhe do të kryejë detyra që lidhen me monitorimin e zhvillimit të aktiviteteve të përcaktuara duke verifikuar fazë pas faze përputhjen mes objektivave dhe rezultateve të arritura. Gjithashtu grupi përcakton shkaqet dhe pengesat që parandalojnë arritjen e rezultateve të pritshme; propozon zgjidhje për problemet duke përfshirë modifikime të mundshme të memorandumit dhe anekseve përkatëse; propozon iniciativa specifike për rritjen profesionale të statistikienëve; inicion projekte kërkimore dhe studimore për çështje specifike të interesit të përbashkët, si dhe përpiket të hartojë strategji të caktuara për përhapjen e njohurive të Acquis Communautaire në atë fushë.

**Të dhënat administrative dhe informacioni statistikor.** Në vitin 1992, Konferenca e Statisticienëve Europiane, (CES) përcaktoi një ndër parimet themelore të statistikës zyrtare, që u adoptua menjëherë nga Komisioni Ekonomik për Europën (ECE) dhe nga Komisioni i Statistikës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (UNSD), që **“të dhënat individuale të grumbulluara për qëllime statistikore mund të merren nga çdo lloj burimi, si nga një vrojtim statistikor apo edhe nga një dokumentacion administrativ. Zyrat qëndrore të statistikës duhet të zgjedhin burimin më të përshtatshëm në lidhje me cilësinë, me shpejtësinë, me koston dhe me detyrimet e atij që përgjigjet”.**

Në Shqipëri prej kohësh administrata publike ka përbërë gjithmonë burim primar për tërheqjen e të dhënave elementare. Historikisht ky sektor ka pasur një sasi të madhe informacioni të marrë nga aktet administrative që plotësohen çdo ditë. Nga Zyrat e Gjëndjes Civile janë marrë të dhëna për të lindurit, të vdekurit dhe të martuarit. Nga Zyrat e Drejtorive Arsimore janë marrë të dhëna për shkollat dhe mbarëvajtjen e tyre. Nga Zyra e Tatimeve janë marrë të dhëna për lindjen e një biznesi, karakteristika bazike dhe mbarëvajtjen e tij. Nga Zyrat e Organeve Juridike janë marrë të dhëna mbi proceset gjyqësore, e kështu me rradhë. INSTAT grumbullon kështu të dhëna në letër që i vijnë në ndihmë në veprimtarinë e statistikore. Akoma për disa nga entet e administratës publike qëndrore ose lokale, në INSTAT ende raportohet në formën « e vjeter » të grumbullimit të të dhënave.

Në hartimin e këtij Programi Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare, është mbajtur parasysh angazhimi për vendosjen e një efijence në Sistemin Statistikor Kombëtar. Ky angazhim përcakton që zyrat e statistikës, ato të administratës qëndrore dhe të enteve lokale, që kontribuojnë në nxitjen dhe në zhvillimin informatik të statistikave, të arkivave dhe të dhënave administrative duhet të mbështeten nga INSTAT i cili është shtylla qëndrore e Sistemit.

Këto burime ruajnë karakterin e tyre të privilegjuar, për sa kohë ato i shërbejnë një profili statistikor, mundësinë për të vjelur të dhëna të diçkaje të nevojshme, dhe jo të dhëna që shpesh paraqesin mënyrën e procedurave administrative. Prandaj më parë duhen fiksuar mënyrat e “terheqjes” së të dhënave administrative.

Duke vepruar në një mënyrë të tillë, aktivizohen burime statistikore që janë me kosto grumbullimi gati zero, lindin procese që më vonë lidhin automatikisht flukset informative të dëshiruara, favorizohet rritja e kulturës statistikore pranë administratës publike, pakësohet ngarkesa e padëshirueshme e njësive statistikore, të cilave zakonisht u kërkohet të plotësojnë shumë pyetësore si dhe analizohet më mirë situata e treguesve mikro dhe makro.

Përdorimi i të dhënave administrative për qëllime statistikore është një proces i realizueshëm, por kjo situatë kërkon të evidentohen detyrimisht ndërhyrje të studiuara nga Drejtoria Qëndrore e INSTAT. Ai duhet të luajë rolin jo vetëm të nxitësit të informatizimit të procedurave administrative, por edhe të përdorimit të nomenklaturave të miratuara që janë të pranishëm në të gjitha strukturat e administratës publike. Kooperimi midis INSTAT dhe organizmave të tjerë publike (si në nivel qëndror ashtu edhe në nivel lokal) për t'i bërë ato bashkëprodhues të informacionit si dhe përdorues të dorës së parë.

**Detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit për INSTAT-in.** Brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit, Shqipëria do të dërgojë në Komisionin e Komunitetit Europian, PBB-në e saj për frymë të harmonizuar me nivelin e NUTS II.

**Objektivat e përafrimit të legjisllacionit shqiptar në fushën e statistikës me Acquis Communautaire.** Vihet theksi në arritjen e standarteve të parimeve të OKB-së, legjisllacionit Europian statistikor dhe forcimin e INSTAT me qëllim sigurimin e një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm statistikor

i aftë të ofrojë të dhëna objektive e të sakta për të planifikuar e ndjekur procesin e reformave. Një ndër prioritetet është përafrimi i legjislacionit vendas me Acquis Communautaire.

Objektivat globale do të përgatisin të gjithë shoqërinë për epokën dixhitale, duke tërhequr investimet dhe siguruar ndëroperimin e rrjeteve dhe shërbimeve.

**Detyrimet që rrjedhin nga Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit.** Instituti i Statistikës, INSTAT, ka për detyrë të prodhojë statistika transparente, të paanëshme dhe në kohë, që ndihmojnë përdoruesit të gjykojnë mbi ecurinë e proceseve transformuese të zhvillimit në vend. Këtë mision INSTAT-i e ushtron në përputhje me mandatin e tij publik dhe institucional duke synuar ngritjen e organizuar të një sistemi statistikor kombëtar duke maksimizuar përdorimin e të gjitha burimeve ekzistuese të informacionit.

**Procedura e hartimit të Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare (PSZ).** Gjatë këtij procesi INSTAT është udhëhequr nga modele të ngjashme të vendeve të Bashkimit Europian, nga statusi aktual i zhvillimit të INSTAT si dhe nga analiza e kostos për çdo proces. Të dhënat që INSTAT prodhon nuk mund të qëndrojnë vetëm si të dhëna kombëtare, ato duhet të harmonizohen në një kuadër më global, ndaj edhe hartimi i PSZ është bazuar në Statistical Compendium dhe në aktet legjislative të Komunitetit Europian. Dizenjimi aktual i Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare përkon në përpjekjet e administratës publike shqiptare në hartimin e planit për zbatim të përparësive të partneritetit europian.

Hartimi i PSZ u mbështet në një pyetsor të hartuar për këtë qëllim, Aneksi A. Në këtë pyetsor janë përfshirë kërkesat e ligjit të statistikës për hartimin e PSZ:

- përshkrimi i statistikave kryesore dhe treguesit që vihen në dispozicion
- institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e rezultateve
- klasifikimet që përdoren
- nivelin në të cilin statistikat dhe treguesit bëhen të disponueshëm
- frekuencën me të cilën statistikat dhe treguesit bëhen të disponueshëm
- vitin në të cilin do të shpërndahen statistikat dhe treguesit
- vitin në të cilin do të bëhen për herë të parë të disponueshëm statistikat dhe treguesit e rinj
- listën e burimeve të përdorura për nxjerrjen e statistikave dhe të treguesve
- burimet administrative
- listën e vrojttimeve që duhen të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për projektimin dhe drejtimin e tyre
- pyetësorët e plotësuar, regjistrimet e të dhënave dhe rezultatet që duhet t'i kalojnë INSTAT-it dhe agjensive statistikore si dhe kufijtë kohorë për këto veprimtari.

Krijimi i një sistemi transparent informimi, jo vetëm mbi të dhënën numerike, por edhe mbi mënyrën se si është llogaritur e dhëna, ndryshimet metodologjike që pëson në harkun kohor të një periudhe njëvjeçare ose më shumë, por mbi të gjitha krijimi i një sistemi, i aftë të vetëqëndrojë pavarësisht nga lëvizjet e ekspertëve, e ka drejtuar nevojën e INSTAT drejt krijimit të Sistemit të Integruar të Informacionit. Ngritja e këtij sistemi si një ndërmarrje më vehte nuk i shton asgjë të re sasisë së informacionit të prodhuar, por e bën të krahasuar mënyrën se si prodhohet informacioni në Shqipëri. Për këtë arsye manuali i Partneritetit Europian dhe Statistical Compendium janë krahasuar për çdo fushë statistike ku Shqipëria prodhon të dhëna.

**Agjensitë statistikore.** Në ligjin « Për statistikën », **Agjensi statistikore** quhet autoriteti përveç Institutit të Statistikës i autorizuar sipas programit të statistikave zyrtare për të ndërmarrë veprimtari për nxjerrjen e statistikave zyrtare. Ndërsa me **nxjerrje të statistikave zyrtare**, po në këtë ligj, kuptohet tërësia e veprimtarive të nevojshme për përgatitjen, mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, analizimin, interpretimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore. Sot, me të gjitha përpjekjet që janë bërë, jo vetëm në INSTAT por edhe në Ministrinë e Financës, Departamentin e Administratës Publike, është arritur të evidentohet plotësisht në formë elektronike, numri dhe shpërndarja e plotë e Institucioneve publike, buxhetore ose jo, që operojnë në territorin e vendit. Edhe në bazë të ligjit, jo të gjithë kanë të drejtë të prodhojnë informacion statistikor zyrtar. Disa prej tyre operojnë dhe grumbullojnë informacion statistikor si detyrë të lënë prej INSTAT. Disa të tjera në zbatim të detyrës së tyre institucionale grumbullojnë informacion që është i rëndësishëm të transferohet në INSTAT për prodhimin e të dhënave zyrtare. Tabela 1 jep numrin e aktiviteteve të kryera nga çdo Agjensi statistikore, aktivitete që bëjnë pjesë në listën e statistikave zyrtare.

Tabela 1. Numri i Aktiviteteve statistikore për INSTAT dhe Agjensitë statistikore

Agjensia Statistikore	Numri i Aktiviteteve
Instituti i Statistikës	101
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit	6
Ministria e Financës	5
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	6
Banka e Shqipërisë	8
Gjithsej	126

## 2. OBJEKTIVAT KRYESORE TË PROGRAMIT 2007-2011

### Objektiva strategjike :

- Ngritja dhe forcimi i identitetit të sistemit dhe të imazhit të statistikës zyrtare.
- Zhvillimi i kulturës statistikore në vend dhe shtimi i përdorimit të metodave statistikore në të dhënat që vijnë prej administratës publike.
- Edukimi e përhapja e kulturës statistikore dhe stimulimi i kërkesës për informacion statistikor.
- Integrimi dhe harmonizimi i metodave të prodhimit të informacionit statistikor në funksion të kërkesave e rekomandimeve europiane e ndërkombëtare
- Sigurimi i një Bashkëpunimi Statistikor ndërmjet të gjithë agjensive statistikore.

### Objektivat e prodhimit dhe shpërndarjes:

- Rritja e kapacitetit statistikor, nëpërmjet shtimit të burimeve primare të të dhënave.
- Përmirësimi i statistikave ekonomike nëpërmjet shtimit të treguesve sasiorë.
- Konturimi më i plotë dhe afatgjatë i statistikave sociale.
- Hartimi i treguesve të rinj në fushat statistikore më të pa eksploruara por me një kërkesë të madhe për informacion.
- Zhvillimi i sistemeve informatike statistikore të integruara.

### Objektivat e infrastrukturës statistikore:

- Trainimi në brëndësi të sistemit statistikor për metodat dhe klasifikimet standarte për harmonizimin e statistikave.
- Forcimi i rolit të zyrave të statistikës të administratave qendrore e lokale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së informacionit nga burimet administrative dhe përdorimin e tij në procesin e vendimarrjes.
- Përlllogaritja e kostos individuale dhe totale të produkteve të programit të statistikave zyrtare.
- Fuqizimi i sektoreve mbështetës të INSTAT si metodologjia, kartografia, nomenklatura, mirëmbajtja e rrjetit lokal të kompjuterave.



### 3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT PESËVJEÇAR TË STATISTIKAVE ZYRTARE

Neni 6 dhe 7 i ligjit “Për Statistikat” mund të përdoren si nene që mbështesin aktivitetet e INSTAT në drejtim të aplikimit të parimeve të menaxhimit cilësor (Quality Management). INSTAT në bazë të ligjit është i caktuar të kryejë vërtetime, të kordinojë grumbullimin e informacionit administrativ, dhe të kontrollojë cilësinë e regjistrave të të dhënave administrative.

#### 3.1 Drejtimi cilësor në sistemin kombëtar të statistikave

Ky koncept për shoqërinë shqiptare është shumë i ri. Natyrisht që edhe për INSTAT është një koncept i ri, por falë prezencës së asistencës së huaj dhe lidhjeve ndërkombëtare ekzistojnë njohuritë e para për të kuptuar këtë. Aktualisht INSTAT nuk ka ende përcaktuar plotësisht se cili model do të ndiqet për të matur “quality management”. Kjo sepse shkalla e zhvillimit të sistemit statistikor kombëtar nuk lejon plotësisht ndjekjen e EFQM (European Foundation for Quality Management) apo SCBI (Statistical Capacities Building Indicators propozuar nga grupi PARIS 21). Në vlerësimin e cilësisë së drejtimit gjykojmë që në të vërtetë ka komponentë me kah vlerësimi nga jashtë, të cilat në një stad të dhënë të zhvillimit të kulturës statistikore në shoqëri marrin rëndësi të veçantë dhe zhvillimi i tyre nuk kushtëzohet vetëm nga zhvillimi i produktit statistikor në vend. Këta janë:

- Përdoruesit e të dhënave (Klientet).
- Financimi (nga burimet e brendshme dhe /ose nga të jashtme, kryesisht donatorët dhe asistencë teknike e tyre)
- Legjislacioni në fuqi, i cili i jep legjitimitet e duhur zyrës statistikore të ndërmarrë operacionet e transferimit të të dhënave
- Furnizuesit e informacionit (subjektet statistikore)

Ndërsa ka komponentë që në të vërtetë ndikojnë në produktin statistikor të vetë zyrës së statistikës:

- Drejtimi që sjell vizionin, drejtimin dhe planifikimin.
- Proçeset operacionale, që lejojnë transformimin e të dhënave dhe prodhimin e produktit të kualifikuar.
- Burimet njerëzore dhe investimi në to

Të gjitha këto elemente që duhen ndërtuar për të matur cilësinë e drejtimit, do të fillojnë gjatë këtij programi Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare. Përpara se të fillohet implementimi i këtij sistemi kërkohet që Këshilli i Statistikës të marrë në konsideratë modelet e matjes së cilësisë së drejtimit dhe të vendosë mbi treguesit që do të jenë ato që do të shërbejnë më mirë për INSTAT.

#### 3.2 Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet )

Kjo analizë bëhet duke vënë në qendër sistemin statistikor kombëtar dhe INSTAT si implementuesi kryesor i sistemit. Natyrisht duhet të kemi parasysh se jeta e gjithë këtij sistemi është e shkurtër dhe ende shumë e brishtë.

*Strengths (FUQITË)*

Aktualisht ka një ligj të ri statistikës që lejon një veprimatri më të organizuar, me një mision të qartë për INSTAT dhe me përcaktim të detyrave të agjensive të tjera statistikore mbi grumbullimin dhe përdorimin e informacionit. Ka një vizion që mundëson lidhjen e operacioneve statistikore me financimet e nevojshme dhe gjithmonë synohet të rritet produkti statistikor me aq sa është mundësia e kapacitetit absorbues. INSTAT ka krijuar një reputacion në rritje të independencës profesionale midis përdoruesve vendas. Shkalla e të diplomuarve në INSTAT është e lartë si në Drejtorinë Qëndrore ashtu edhe në ato Rajonale. Stafit është i motivuar dhe gjithashtu zotëron njohuri të gjuhëve perëndimore. Moshë mesatare e stafit është e re dhe për to është investuar në trainime si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Edhe kushtet e punës për njerëzit janë të mjaftueshme e komode.

Procesi i përafrimit të legjisllacionit kombëtar me ato Komunitar ka kërkuar fillimin e përgatitjeve për zhvillimin e strategjive të zhvillimit të statistikave ekonomike, sociale, mjedisore si dhe të teknologjisë së informacionit dhe të komunikacionit. INSTAT gjithashtu gëzon edhe një reputacion të mirë midis donatorëve.

*Weaknesses (DOBËSITË)*

Ende nuk ka një model që të tregojë se kujt i përafrohet sistemi statistikor kombëtar. Detyrat midis agjensive për të ngritur, përmirësuar dhe mirëmbajtur serinë e tyre të të dhënave administrative nuk janë të qarta. Çdo gjë pritet nga INSTAT edhe për të kuptuar ecuri që me të vërtetë janë shumë sektoriale. INSTAT për arsye të burimeve të pakta financiare që disponon nuk krijon një masë kritike me të dhëna të afta për të dhënë një panoramë ekonomike sociale në periudhë më të shkurtra se tremujore ose vjetore.

Staf i limituar në numër dhe me njohuri jo shumë të thella në lëndët e statistikës moderne. Stafit ende nuk ndihet pronar i të dhënës së vet, edhe pse së fundmi ka një përcaktim të dedikuar se kush bën çfarë. Mungon një organizim permanent për të kontrolluar cilësinë e të dhënave që shkon drejt përdoruesit. Nuk ka një kuptim të barabartë midis INSTAT dhe agjensive të tjera statistikore për metodat statistikore dhe klasifikimet që duhen përdorur.

Hapësira shumë e kufizuar e punës krijon vështirësi të përditshme. Të shoqëruara këto edhe me ndërprerje të energjisë elektrike e bëjnë shumë të vështirë ecurinë normale të programit.

Shumë shpesh prania e fondeve donatore e pashoqeruar me një “exit strategy” financiare nga ana e INSTAT vështirëson mbajtjen e disa treguesve që kanë një kosto të caktuar.

*Opportunities (MUNDESITË)*

Nënshkrimi i marrëveshjes së Stabilizim Asocimit do të rrisë me siguri sensibilizimin ndaj INSTAT. Rritja e detyrimeve kombëtare do të sjellë një shtim në burimet mbështetëse të INSTAT. Me siguri që shpërndarja e rrjetit informatik në vend do të përmirësojë cilësinë dhe shpejtësinë e grumbullimit të të dhënave. Edhe ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, sidomos i bizneseve që në procesin e vendimarrjes do t'i duhen të dhëna, është një mundësi shumë potenciale që burimet e INSTAT të rriten. Hyrja në OBT gjithashtu do të drejtojë më mirë kërkesën për informacion statistikor nga INSTAT.

*Threats (KËRCËNIMET)*

Kërcënimet më të mëdha vijnë nga mos garantimi i cilësisë dhe mos nxjerrja në kohë e informacionit. Këto me siguri sjellin vështirësi për të lejuar hartimin e drejtë të politikave me karakter të shpejtë dhe me procesin e vendimarrjes. Zvogëlimi i stafit të agjencive statistikore në njësinë që trajton të dhënat administrative përbën një problem, për aq kohë sa në reformën e administratës publike nuk do të vendoset që kjo struktura të jetë permanente pranë ketyre njësisë.

Shkalla e mospërgjegjes të atyre që furnizojnë me të dhëna, nuk ka qenë një problem për INSTAT, por është rreziku i shndërrimit në një problem për INSTAT është prezent. Firmat mund të refuzojnë përgjigjen po ashtu edhe familjet, ndaj duhet të zhvillohen mjete statistikore të afta për të trajtuar mospërgjigjet.

### 3.3 Klasifikimet

#### *Klasifikimet në fushën e statistikave sociale*

Ndryshimet thelbësore dhe të shpejta në tregun e punës, kanë nevojë për forcë pune të kualifikuar dhe të adaptueshme. Gjithashtu kërkohet që kjo forcë pune e kualifikuar të punësohet në tregun aktual të punës me qëllim përmirësimin cilësor të jetesës. Në sferën ndërkombëtare burimet e destinuar për identifikimin e këtyre fenomeneve janë në rritje. Përpjekje të mëdha janë bërë për transformimin e unifikuar të këtyre fenomeneve në konceptet analitike dhe statistike, formimin e metodologjive të krahasuara, mjetet për monitorimin dhe shpërndarjen e tyre, të cilat janë të nevojshme për menaxhimin dhe orientimin, të përfshira në thelbin e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare (politika sociale dhe punësimi, edukimi dhe trainimi, lëvizja e lirë e njerëzve).

Midis këtyre mjeteve, klasifikimet kanë një rëndësi shumë të madhe në fushën e statistikave sociale. Institucionet ndërkombëtare si UNESCO, OECD dhe Eurostat në lidhje me klasifikimet në fushën sociale, kanë vënë si qëllim përmirësimin e përdorimit e klasifikimit ndërkombëtar të revizionuar ISCED-97 si dhe manualin mbi “edukimin dhe trainimin”. Aktualisht ky është klasifikimi që përdoret në vend për të cilin INSTAT është asistuar nga ES. Ndërsa në fushën e statistikave të punës, përdoret ISCO-88, i cili gjithashtu është parashikuar të revizionohet nga dokumentet e programit ndërkombëtar statistikor.

#### *Mbështetja statistikore*

INSTAT, si anëtar pjesëmarrës në Konferencën e Statisticieëve European do të monitorojë zhvillimin e këtyre klasifikimeve ndërkombëtare dhe do të sjellë në realitetin kombëtar çdo ndryshim që do të ndodhë. Gjithashtu këto çështje do të diskutohen në Këshillin Kombëtar të Nomenklaturave.

#### *Drejtimet kryesore për periudhën 2007-2011*

- Informimi rreth rëndësisë së klasifikimeve në fushën sociale, stimulimi për të marrë pjesë në përgatitjen dhe rinovimin e tyre
- Sigurimi i një kuptimi uniform, përdorimi dhe interpretimi i klasifikimeve standarde ndërkombëtare në fushën sociale, nga INSTAT dhe Agjencitë e tjera Statistikore
- Monitorimi dhe klasifikimi unanim i fenomeneve të reja në termat e kategorive thelbësore siç janë; kualifikimet profesionale kombëtare në sistemet e klasifikimit
- Vazhdimi i punës për adaptimin e sistemit të klasifikimeve ndërkombëtare në fushën e edukimit
- Përgatitja e klasifikimeve teknike dhe operacionale si dhe lidhjet për anketa specifike individuale në fushën e statistikave sociale
- Vazhdimi i punës për automatizimin e ISCO 88 dhe përdorimit të tij autonom në anketa të ndryshme

### ***Klasifikimet në fushën e statistikave ekonomike***

Aktualisht në vend përdoren klasifikimet e veprimtarive ekonomike NVE-NACE REV 1 ose ISIC REV 3 Ndryshimet që ndodhin në diskutimet e statisticienëve europianë mbi përmirësimet në NACE, transferohen edhe në Shqipëri. Komisioni kombëtar i Nomenklaturave diskuton dhe INSTAT vendos për shkallën e adaptimit. Aktualisht INSTAT ka nxjerrë në qarkullim një botim të përmirësuar të Nomenklaturës të Veprimtarisë Ekonomike. NVE aktualisht duhet të rrisë njohjen ndërmjet stafit të agjensive të tjera statistikore, sidomos në Zyrën e Tatimeve dhe atë të Doganave. Në kuadrin e nevojave specifike të përdoruesve të klasifikimeve në Shqipëri duhet të konsiderohet dhe të mundësohet zberthimi në nivel individual i klasave të përcaktuara. Edhe klasifikimi europian i produkteve sipas aktiviteteve (CPA) që është adaptuar në Shqipëri, kërkon të ndiqet në çdo hallkë të njohjes nga agjensi të tilla si Ministria e Ekonomisë, Industrisë, Bujqësisë dhe Ushqimit, zyrat e tatimeve, etj. Edhe klasifikime të tjera mbështetëse për veprimtari statistikore të agjensive të veçanta janë aktualisht në përdorim, por shtrirja e tyre nuk është kaq horizontale sa të kërkojë një koment më vete.

### ***Mbështetja statistikore***

Klasifikimi i veprimtarive ekonomike (NVE-NACE) dhe Klasifikimi i produkteve sipas Aktiviteteve (CPA) janë standarte statistikore të detyrueshme në EU, të cilat sigurojnë krahasimin e të dhënave midis vendeve anëtare. Edhe pse Shqipëria nuk është vend anëtar i EU, zbaton këto klasifikime në nivel kombëtar.

### ***Detyrat kryesore për periudhën 2007-2011***

- Të monitorojë aktivitetet e EU lidhur me rishikimin e klasifikimit të aktiviteteve dhe produkteve.
- Të sigurojë shpërndarjen e publikimit të përmirësura të NVE në të gjitha nivelet e Agjensive statistikore
- Të mbajë dhe të përditësojë tabelën e korespondencës mes klasifikimeve ekonomike.

### ***Klasifikimi i Kombinuar***

Klasifikimi i Kombinuar (CN) është një klasifikim europian për mallrat, i përdorur kryesisht në klasifikimin e doganave, që shërben gjithashtu dhe për nevojat e statistikave të tregtisë së jashtme. Është futur fillimisht në vitin 1999. Klasifikimi i Kombinuar bazohet mbi një klasifikim ndërkombëtar HS ( të Sistemit të Harmonizuar), i përdorur në më shumë se 180 vende dhe bashkime doganore në mbarë botën ( 98% e tregtisë botërore). Sistemi i Harmonizuar pasoi progresin teknologjik dhe zhvillimet në tregtinë ndërkombëtare duke përshtatur përmirësimet dhe plotësimet e bëra.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganeve është institucioni i ngarkuar për të realizuar versionin kombëtar të Klasifikimit të Kombinuar. Deri tani CN ndërkombëtare është e ndërtuar në nivel tetë-dixhit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganeve e mbështetur nga një grup ekspertësh ka shtuar (detajuar) dixhitet për arsye kombëtare. Klasifikimi i Kombinuar ndryshon çdo vit, në nivelin Europian dhe Kombëtar, në linjë me kërkesa të ndryshme si politika e tregtisë së jashtme, ndryshimet në lëvizjen e mallrave, teknologjia e përmirësuar, nevojat statistikore, etj.

**Mbështetja statistikore**

Në EU, Klasifikimi i Kombinuar përdoret në statistikat e tregtisë me Vendet e Treta (Extrastat) dhe statistikat e tregtisë mes Vendeve Anëtare (Intrastat). Klasifikimi i Kombinuar është gjithashtu i përdorur për qëllime statistikore, krahas klasifikimeve të tjera statistikore si SITC, SKD ose NACE, NIP ose Prodcom, CPA, ISIC, BEC, etj. Për shkak të këtyre lidhjeve reciproke, të dhënat nga deklaratat doganore mund të paraqiten në klasifikime të ndryshme, gjë që mundëson përdorimin e të dhënave të tregtisë së jashtme për nevoja dhe analiza të ndryshme. Përshtatja vjetore e statistikave të tregtisë së jashtme ndaj ndryshimeve të Klasifikimit të Kombinuar është një kërkesë dhe një detyrë që merr kohë, mqs tekste vetësuarues dhe tabela me lidhje të ndërsjellë, duhet të adaptohen për nevoja të përpunimit të të dhënave automatike. Për këtë arsye në INSTAT, punohet për të përditësuar tabelën e korrespondences në mënyrë periodike sa herë që ka ndryshime në EU dhe në vend.

**Detyrat kyessore për periudhën 2007 – 2011**

- Në vijim të Legjislacionit European, versioni kombëtar i Klasifikimit të Kombinuar duhet të mbahet i përditësuar edhe në zbatim të Marëveshjes së Stabilizim-Asocimit.
- INSTAT të vazhdojë të komunikojë me Drejtorinë Përgjithme të Doganave për të ruajtur aktualitetin e tabelës së korespondencës.
- INSTAT të vazhdojë të dërgojë të dhënat në ES sipas standartit të COMEXT

Klasifikimet që zbatohen në Shqipëri dhe koha e tyre e implementimit paraqitet në tabelën 3

Tabela 3. Klasifikimet statistikore dhe koha e vendosjes së tyre në përdorim

Akronimi		Emërtimi	Përputhmëria	Zbatimi
Shqip	Anglisht			
NVE	NACE Rev1	Klasifikimi i aktiviteteve ekonomike	EU	1994
NP	CPA	Klasifikimi i produkteve	EU	1996
SLLK93	SNA93	Sistemi i Llogarive Kombëtare	UN	1996
SELL95	ESA95	Sistemi European i Llogarive	EU	2000
NK	CN	Klasifikimi i kombinuar	EU	1999
	HS	Sistemi i harmonizuar	UN	1996
KRrD	CP	Klasifikimi i Rregjimit Doganor	UN	1996
KSNT	SITC Rev.3	Klasifikimi Standart i Nomenklaturës së Tregtisë	UN	1996
NVT	ISO(α2)	Klasifikimi i vendeve dhe territoreve	EU	1993
KTM		Klasifikimi i tregtisë së mallrave	DOGANA-INSTAT	1996
KKSD	-	Klasifikimi i karakteristikave specifike të demografisë	Kombëtar, EU	1993
KNAT	-	Klasifikimi i Ndarjes Administrative Territoriale	Kombëtar <sup>1</sup>	1993
KN	CC	Klasifikimi i Ndërtimit	EU	1998
KNSA97	ISCED97	Klasifikimi Ndërkombëtar Standart i Arsimit	UN	1998
KNSSHV	ICD-9 <sup>2</sup>	Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve	UN	1993
NPP	ISCO-88	Klasifikimi i punësimit dhe profesioneve	ILO	1995
NPK	COICOP	Klasifikimi i produkteve të konsumit	UN	2000
KEB	GFS 98	Klasifikimi ekonomik buxhetor	FMN	1998 <sup>3</sup>
KFQ	COFOG	Klasifikimi i funksionimit të qeverisë	EU	1998 <sup>4</sup>
NVM	SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të medha	Min.Ekonomisë-INSTAT	2003
KT	WTO	Klasifikimi i turizmit	UN	1993
KSMT	NST	Klasifikimi standart i mallrave të transportit	EU	1996

<sup>1</sup> Jo plotësisht në përputhje me EU

<sup>2</sup> ICD10 është përkthyer por akoma nuk është aplikuar. Pritet të aplikohet në vitin 2008

<sup>3</sup> Implementuar pjesërisht për nxjerjen e Llogarive Kombëtare

<sup>4</sup> Implementuar për të nxjere Shpenzimet Buxhetore

### **3.4 Trainimi i statisticienëve**

Në zhvillimin strategjik të programit për trainimin e statisticienëve, për këtë periudhë INSTAT do të fokusohet kryesisht në trainime të përgjithshme sipas fushave të interesit të projekteve në implementim. Gjithashtu edhe njohuri mbi metodologji të reja do të përfshihen në edukimin e stafit të stimuluar nga zhvillimi i teknologjisë së informacionit..

#### **Qëllimet kryesore për periudhën 2007 – 2011**

- Konsolidimi i njohurive bazë statistikore (metodologji anketimi dhe kampionare, lidhje të dhënash nga burime të ndryshme, softëare-sh për përpunimin e të dhënave, mbrojtje të dhënash etj.)
- Përvetësim dhe përdorim i metodologjive të reja (metoda imputimi të cilat përdorin në mënyrë të konsiderueshme teknologji të përparuar informacioni, modele ekonometrike për vlerësime provizore dhe definitive, rregullime sezonale), pjesërisht të ofruara nga institucionet ndërkombëtare.
- Organizimi i seminarëve për punonjësit e INSTAT dhe për punonjësit e Agjencive statistikore për të këmbyer opinione dhe eksperiencë, mbi metodat më të mira praktike bashkëkohore .
- Përgatitje e manualeve të duhur dhe teksteve për programin e trainimit të brëndshëm i cili do të jetë i disponueshem në Internet për të gjithë punonjësit e INSTAT si për punonjësit e agjensive statistikore.

### **3.5 Shërbimet e teknologjisë së Informacionit dhe të Infrastrukturës**

Në strategjinë e zhvillimit për periudhën pesëvjeçare është esenciale që ngarkesa në raportimet e njësive që plotësojnë të dhëna të zvogëlohet, kështu që ato do të jenë më mirë të orientuara në drejtim të nevojave të përdoruesve, të cilësisë së të dhënave dhe në gjetjen e mënyrën që standartizojnë procedurat e arkivimit. Zhvillimi i infrastrukturës së shërbimeve në kuadër të programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare të vendit deri në fund të 2011 do të mbështesë me prioritet si më poshtë:

- Transmetimin elektronik të të dhënave dhe shërbimeve për përdoruesit e organizatave Ndërkombëtare
- Përditësimin e Website të INSTAT me të dhënat më të fundit në kohë reale.
- Standartizimin e procedurave të arkivimit elektronik.
- Nxitjen e një inisiativë pilote për grumbullimin informatik të të dhënave nga ndërmarrjet e mëdha

### **3.6 Politika e shpërndarjes**

Në shpërndarjen e të dhënave, INSTAT po përpaket të krijojë një mjedis user-friendly për të gjithë përdoruesit. Për këtë qëllim INSTAT do të adaptojë prodhimin e vet sa më shumë të jetë e mundur sipas nevojave të ndryshme të përdoruesit. Aktualisht ai ka filluar të mendojë për një bazë të dhënash dhe për një politike marketingu me qëllim gjenerimin modest të të ardhurave. Qëllimet strategjike më të rëndësishme janë përcaktuar gjithashtu:

- Akses të barabartë në rezultatet statistikore
- Profesionalizem
- Transparencë
- Mirëkuptim me përdoruesit
- Akses të përmirësuar në të dhëna dhe informacione statistikore nëpërmjet **World Wide Web**
- Publikime në gjuhët shqipe dhe angleze, sa më shumë të jetë e mundur.

Po ashtu plotësimi në kohë i të gjithë kërkesave ndërkombëtare që i drejtohen INSTAT është një nga detyrat e rëndësishme.

INSTAT shpall paraprakisht listen e publikimeve të veta, për gjithë vitin. Çdo publikim i prodhuar shoqërohet me një njoftim për shtyp i cili i dërgohet çdo njësie mediatike të shkruar apo elektronike. Tani për tani përdoruesit janë të ndarë në kater grupe: ndërmarrje, sektori publik, publiku i përgjithshëm dhe kërkuesit shkencore e universitetet. Detyrat e rëndësishme për të ardhmen janë si më poshte:

- Një listë më e detajuar e përdoruesve sipas kërkesave të tyre specifike
- Trainim i vazhdueshëm i përdoruesve
- Mbajtja e statistikave të rregullta mbi përdoruesit dhe ndjekja e shkallës së kënaqshmërisë së tyre.

### **3.7 Regjistrat**

INSTAT krijon, mirëmban dhe është përgjegjës për regjistrat e tij statistikorë. Regjistri i tij më i rëndësishëm është ai i ndërmarrjeve që përdoret si baza për të realizuar vërtetimet me zgjedhje pranë tyre.

#### ***Regjistri Statistikor i ndërmarrjeve***

Ky regjistër u krijua si nevojë e domosdoshme që në vitin 1994, për të ndjekur ndryshimet në sektorin e ndërmarrjeve shtetërore dhe lindjen e ndërmarrjeve private. Fillimisht lindja e tij erdhi si një punë e përbashkët e realizuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe u krijua regjistri administrativ, i cili u shndërrua në një regjister statistikor mbasi përditësimi i tij bëhej mbi bazën e vërtetimeve statistikore dhe bilanceve të konsoliduara të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes. Baza e krijimit të këtij regjistri ishte NVE dhe kodet fiskale të dhëna bizneseve. Ai është vazhdimisht në përditësim përse kohë INSTAT kryen vërtetime dhe për sa kohë më shumë karakteristika kerkohen të përfshihen në te. Ky regjister përveç se ndjek vendodhjen e ndërmarrjes, formën legale të shfaqjes së saj, llojin e aktivitetit që ajo kryen, ndjek edhe numrin e punonjësve dhe shifrën e afarizmit të tyre. Plotësimi i këtij regjistri edhe me njësitë lokale të bizneseve do të ndihmojë për të njohur më mirë popullatën e bizneseve në vend. Kjo do të jetë sfida më e madhe.

#### ***Regjistri administratës publike***

Ky është një regjister ende në krijim. INSTAT bashkëpunoi me DAP dhe Ministrinë Financave për të krijuar bazën e këtij regjistri. Synimi është që gjatë kësaj periudhe Pesëvjeçare ai të konsolidohet dhe

të përdoret për të ndjekur statistikat e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve si në terma identifikuese, ashtu edhe për nevoja të llogarive kombëtare mbi shpenzimet që kryejne dhe shifrën e afarizmit që realizojnë. Ky regjister do të unifikohet mbi bazën e NVE ndërsa kodet numerike (fiskale) do të gjenerohen si identifikues prej INSTAT.

### **Regjistri i njësive ekonomike familjare bujqësore**

Ky regjister është krijuar në 1998, si produkt i drejtëpërdrejtë i Regjistrimit të Përgjithshëm të njësive ekonomike. Ai nuk është përditësuar që nga momenti i krijimit deri më sot, sepse mjetet statistikore për të kryer këtë nuk kanë qenë të mjaftueshme. Regjistrimi i popullsisë dhe banesave i vitit 2001 krijoi një mundësi për përditësimin e tij, por vetëm për disa nga karakteristikat që ai kishte. Regjistrimi i ardhshëm i njësive ekonomike familiare bujqësore do të jetë një mjet për përditësimin e tij dhe shndërrimin e tij në një mjet statistikor që do të mundësojë vrojtimit me zgjedhje pranë njësive ekonomike bujqësore.

### **Regjistri i Banesave**

Ky regjister u krijua si produkt i Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2001. Përveç se është një listë numerike e koduar, ai ka pjesërisht edhe një formë GIS për disa zona të vendit. Regjistri i Banesave mundësoi egzistencën e një kodi topografik për çdo banesë që INSTAT e gjeneroi sipas një llogjike, që po e ruan të tillë edhe në përditësimin e pjesëshëm që ai i bën pjesëve të vecanta të këtij regjistri. INSTAT kërkon ta ruaje si mjet statistikor edhe në Regjistrimin e ardhshëm të popullsisë dhe banesave.

### **3.8 Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti statistikor**

Për mbrojtjen e të dhënave gjatë procesit të shpërndarjes, INSTAT dhe Agjensitë e tjera statistikore të përfshira në Programin Statistikor, duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhteme për qelizën individuale në tabela. Ajo duhet të përmbajnë të paktën numrin e poshtëshënuar të njësive:

- (a) Për të ashtuquajturat *karakteristikat më të ndjeshme* (besim fetar, kombësi dhe të ngjashme) të paktën dhjetë njësi
- (b) Për të ashtuquajturat *karakteristika të ndjeshme* (të ardhurat) të paktën tre njësi
- (c) Për të ashtuquajturat *karakteristikat më pak të ndjeshme* (demografike) nuk ka limite dhe qelizat me vetëm një njësi, mund të shfaqen.

Për kontrollin e zbulimit të statistikave, do të përdoren paketa të software-ve që janë të disponueshme në Bashkimin Europian dhe përdoren gjithashtu nga Shtetet anëtare. Kontrolli i zbulimit të të dhënave është një fushë në të cilën janë zhvilluar shumë shpejt metoda të reja. INSTAT do të ndjekë metodologjitë e reja si dhe të reja për paketat përkatëse të software-ve, gjithashtu gjatë periudhës 2007 – 2011.



**3.9 Fushat e Aktivitetit Statistikor**

Për të klasifikuar fushat statistikore është përdorur "Statistical Requirements Compendium, 2004" botim i Eurostatit.

Kapitulli	Fusha statistikore		Aktiviteti statistikor		
	Kodi	Emërtimi i fushës	Kodi	Emërtimi i Aktivitetit statistikor	
Infrastruktura statistikore	11	Klasifikimet			
			11101	Klasifikimi i aktiviteve ekonomike	
			11102	Klasifikimi i produkteve	
	12	Trajnimi statistikor			
	13	Përpunimi elektronik i të dhënave			
	14	Teknologjia e informacionit			
	15	Bazat e të dhënave referative			
	16	Informacioni			
	17	Shpërndarja			
	18	Koordinimi statistikor			
	19	Kooperimi ndërkombëtar			
	20	Përgatitja për hyrje në BE			
	22	Kërkimi statistikor			
	24	Regjistrat			
	25	Siguria e të dhënave/Konfidencialiteti			
	29	Maksimizimi i përdorimit të burimeve administrative			
	Statistika sociale dhe demografike	31	Popullsia		
				31101	Lëvizja e popullsisë banuese
				31201	Lindjet e gjalla
				31301	Martesat
			31401	Vdekjet mbi 1 vjec	
			31501	Vdekjet foshnjore	
			31601	Migracioni	
			31701	Koeficiente kryesore demografike	
			31801	Projeksionet e popullsisë	
32		Tregu i punës			
			32101	Të dhëna administrative rreth punësimit dhe pagave	
			32102	Të dhëna administrative rreth papunesisë	
			32103	Vrojtimi i forcave të punës	
33		Arsimi			
			33101	Arsimi parashkollor	
			33201	Arsimi 8 vjeçar	
			33301	Arsimi i mesëm	
			33401	Arsimi i lartë	
			33501	Statistika ekonomike të arsimit publik	
			33601	Arsimi nga anketa	

34	Kultura	
		34101 Institucione që japin shfaqje
		34201 Muze, monumente kulture
		34301 Biblioteka
		34401 Operatore radio televizive
		34501 Galeri artesh
		34601 Sporti
35	Shëndeti	
		35101 Aktiviteti Shëndetësor në Institucionet të shërbimit Parësor
		35201 Aktiviteti i Shërbimit Dytësor ose Spitalor
		35301 Shkaqet e vdekjeve sipas skedës për vdekjet mbi një vjeç.
		35302 Shkaqet e vdekjeve për vdekjet e fëmijve nën 1 vjeç
36	Shpërndarja e të ardhurave dhe kushtet e jetesës	
		36101 Anketa e matjes së nivelit të jetesës pranë familjeve
		36201 Anketa e buxhetit të familjes
37	Mbrojtja sociale	
		37101 Mbrojtja sociale
38	Të tjera statistika sociale dhe demografike	
		38101 Divorcet
		38401 Çështjet penale dhe civile, gjykata e shkallës së parë
		38402 Çështjet penale dhe civile, gjykata e Apelit
		38403 Çështjet penale dhe civile, Gjykata e Lartë
		38501 Krimet dhe zbulimi i tyre
		38601 Të dënuarit
<b>Statistika makro-ekonomike</b>		
40	Llogaritë ekonomike vjetore	
		40201 Prodhimi dhe vlera e shtuar e ndërtimit me çmime korente dhe konstante
		40202 Vlerësimi i konsumit final të administratës publike, komponent i pbb me metodën e shpenzimeve
		40203 Vlerësimi i pbb të aktivitetit jotregtar (administrata publike, arsimit, shëndetësia, etj) me metodën
		40204 Vlerësimi i formimit bruto të kapitalit fikse me çmime korente dhe konstante
		40205 Vlerësimi i ndryshimit të gjëndjeve me çmime korrente e konstante
		40206 Vlerësimi i shpenzimeve buxhetore sipas funksionit
		40207 Llogaritja e taksave mbi produktet
		40208 Llogaritja e subvencioneve mbi produktet
		40209 Prodhimi dhe vlera e shtuar për aktivitetin e sigurimeve me çmime korrente dhe çmime konstante
		40210 Vlerësime për ekonominë e pavarjtuar
		40211 Struktura e kostove ndërmjetëse për tabelën input-output
		40212 Vlerësimi i prodhimit, konsumit dhe vlerës së shtuar për institucionet financiare

	40213	Vlerësimi i shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matur indirekt, fisim
	40214	Prodhimi dhe vlera e shtuar e industrisë me çmime korrente e cmime konstante
	40215	Prodhimi, konsumi ndërmjetës e vlera e shtuar në degën e bujqësisë dhe blegtorisë
	40216	Prodhimi konsumi i ndërmjetëm e vlera e shtuar e peshkimit me çmime korrente e çmime konstante
	40217	Prodhimi, konsumi i ndërmjetëm dhe vlera e shtuar në pyje dhe gjueti
	40218	Vlera e Shtuar Bruto me çmimet bazë dhe PPB me çmimet e tregut, metoda e prodhimit
	40219	Produkti i Brëndshem Bruto sipas metodës së shpenzimeve
41 Llogaritë ekonomike tremujore		
	41101	Llogaritë tremujore të ndërmarrjeve
42 Llogaritë financiare		
	42201	Bilanci financiar i konsoliduar (stock-gjendjet)
<b>Statistika të biznesit</b>		
44 Statistika për aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve		
	44101	Anketa strukturore pranë ndërmarrjeve
	44102	Investimet e realizuara
	44401	Anketa tremujore pranë ndërmarrjeve të industrisë
	44402	Vrojtimi tremujor pranë ndërmarrjeve të ndërtimit
	44403	Vrojtimi tremujor pranë ndërmarrjeve të transportit
	44404	Vrojtimi me zgjedhje pranë ndërmarrjeve të tregtisë
	44405	Vrojtimi tremujor pranë hoteleve
	44406	Tregues të lejeve të ndërtimit
	44407	Të dhëna administrative për Industrinë
	44408	Indeksi i shitjeve
45 Energjia		
	45101	Bilanci Kombetar i Energjise
	45201	Bilanci i energjise elektrike
48 Transporti		
	48101	Inventari i mjeteve të transportit rrugor
	48201	Transporti rrugor urban i udhëtareve
	48401	Rrjeti hekurudhor
	48402	Transporti hekurudhor
	48501	Transporti detar i udhëtareve, mjeteve dhe mallrave
	48600	Transporti ajror
	48801	Aksidente në qarkullimin rrugor
	48901	Transport me tubacion
49 Shoqëria e informacionit		
	49201	Aktiviteti i shërbimit postar
	49301	Aktiviteti i shërbimit telefonik fiks
	49401	Aktiviteti i shërbimit të telefonisë celulare
	49501	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
50 Turizmi		
	50101	Kapaciteti dhe frekuentimi i hoteleve
	50201	Hyrjet dhe daljet e shtetesave shqiptarë dhe të huaj në pikat kufitare

51 Rregjistri i ndërmarrjeve	
51101	Regjistri statistikor i ndërmarrjeve ekonomike jo-bujqësore
51102	Anketa pranë ndërmarrjeve të reja
Statistika monetare, financiare, tregtare dhe Bilanci i Pagesave	
52 Paraja dhe financa	
52301	Llogaritja e kursit të këmbimit
53 Tregtia e mallrave	
53101	Prodhimi statistikave të tregtisë së mallrave
54 Shërbimet tregtare dhe BOP	
54201	Përpilimi i bilancit të pagesave
54202	Anketa e Investimeve të Huaja Direkte
55 Çmimet	
55101	Çmimet e prodhimit
55201	Çmimet e konsumit
55301	Çmimet e ndertimit
55401	Vrojtim mbi Barazine e fuqise blerese
Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi	
61 Përdorimi i tokës	
61101	Përdorimi i tokës
62 Struktura e bujqësisë	
62102	Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore
62103	Vrojtim mbi strukturën e njësive ekonomike bujqësore
63 Statistika monetare të bujqësisë	
63101	Llogaritë ekonomike të bujqësisë
64 Prodhimi i drithërave	
64101	Vrojtimi vjetor bujqësor (bimet e arave dhe pemëtaria )
65 Prodhime blegtorale	
65101	Vrojtimi vjetor bujqësor ( blegtoria )
66 Statistika të agro-industrisë	
66101	Informacion mbi Agro-industrinë
68 Statistika të pylltarisë	
68801	Statistikat e pyjeve
69 Statistika të peshkimit	
69101	Statistikat e peshkimit
Statistika të fushave të tjera	
71 Statistika të mjedisit	
71101	Ajri dhe ndotja atmosferike
71201	Mbrojtja e Zonave Natyrore
71301	Flora dhe fauna
71401	Uji, përdorimi dhe monitorimi i tij
71501	Mbetjet
73 Shkenca dhe teknologjia	
73101	Statistika të kërkimit dhe të zhvillimit
74 Informacioni gjeografik dhe lokal	
74101	Përdorimi i bazës dixhitale për informacion tematik
74102	Përgatitja dhe azhurnimi i hartave dixhitale

**3.10 Analiza e situatës, sipas fushave statistikore****2. STATISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE SOCIALE**

31	Popullsia	2006	2007	2008	2009	2010	2011
31101	Lëvizja e popullsisë banuese	x	x	x	x	x	x
31201	Lindjet e gjalla	x	x	x	x	x	x
31301	Martestat	x	x	x	x	x	x
31401	Vdekjet mbi 1 vjec	x	x	x	x	x	x
31501	Vdekjet foshnjore	x	x	x	x	x	x
31601	Migracioni *)	x	x	x	x	x	x
31701	Koeficiente kryesore demografike	x	x	x	x	x	x
31801	Projeksionet e popullsisë	x	x	x	x	x	x

**x-** indikatorët aktuale

**y-** nevojë për burime shtesë

**z-** mungesë burimesh

**2.1 Objektivat e programit për statistikat demografike**

Statistikat e Popullsisë shërbejnë për të studjuar Popullsinë në aspektin e dimensionit të shpërndarjes hapësinore dhe të strukturës së saj, sipas karakteristikave të ndryshme demografike, sociale dhe ekonomike. Ato ndjekin evolucionin e këtyre ndryshimeve me qëllim që të nxirren në pah ligjshmëritë sipas të cilave prodhohen dukuritë demografike dhe i vë këto njohuri në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

**OBJEKTIVAT:**

- Të përmirësoje formularët e mbledhjes së informacionit demografik si dhe plotshmërinë e cilësinë e tyre
- Të përllogarisë tregues të qendrueshëm mbi popullsinë, në shkallë qarku
- Të bashkëpunojë me institucionet e tjera për mundësimin e të dhënave mbi asil-kërkuesit dhe të huajt që banojnë në Shqipëri
- Të sigurojë informacion të plotë mbi lëvizjet e brendëshme të popullsisë në mënyrë që të përllogarisë popullsinë sipas ndarjeve rajonale
- Të revizionojë projeksionet e popullsisë 2001
- Të fillojë punë përgatitore për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë për 2011.

\*) Përsa i përket statistikave të migracionit ato ndahen në të dhëna mbi imigracionin dhe emigracionin. Të dhënat mbi emigracionin do të merren nga vendet pritëse ku kanë emigruar shqiptarët si: Italia, Greqia, etj.  
Për imigrantët të dhënat merren nga MPÇS dhe MPB

## **2.2. Indikatorët që prodhohen aktualisht**

Demografia mbledh, analizon dhe publikon të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me Popullsinë dhe ndryshimet e saj, dhe:

1. Përlllogarit popullsinë më 1 janar sipas grupmoshave, gjinisë dhe qarqeve
2. Prodhon statistika të plota mbi eventet demografike: lindje, vdekje
3. Prodhon statistika të plota mbi martesat dhe divorcet
4. Siguron informacionin mbi lëvizjet e brendëshme të popullsisë
5. Siguron të dhëna mbi migracionin, fenomen i ri ky për statistikat demografike shqiptare
6. Siguron të dhëna mbi asil-kërkuesit dhe të huajt që punojnë në Shqipëri
7. Mundëson projeksionet e popullsisë në nivel vendi dhe rajoni dhe i përditëson ato me të dhënat vjetore demografike

## **2.3 Rezultatet e pritshme për 2011**

1. Për shkak të karakterit masiv dhe të parregullt të emigracionit shqiptar, nuk ka shifra të sakta zyrtare për shpërndarjen e emigrantëve shqiptarë. Megjithatë në bashkëpunim me institutet e tjera statistikore të vendeve pritëse ose me analiza të drejtuara jepen shifra të përafërta për të shpjeguar shpërndarjen e emigrantëve shqiptarë në këto vende. Me informatizimin e plotë të Zyrrave të Gjëndjeve Civile (Projekt i qeverisë Shqiptare) si dhe me ngritjen e Regjistrimit Kombëtar për emigrantët do të krijohet mundësia e sigurimit të statistikave më të sakta jo vetëm për numrin dhe shpërndarjen e emigrantëve shqiptarë sipas vendeve të ndryshme, por do të krijohet mundësia e njohjes së strukturës së tyre, punësimit sipas degëve ekonomike, dërgesat e tyre, gjë që do të ndihmonte në kanalizimin e tyre drejt biznesit. INSTAT do të jetë përdoruesi kryesor i këtij regjistri.

2. Sektori është përfshirje në procesin e diskutimit të Rekomandimeve të UNECE/Eurostat mbi Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave –2010. Gjithashtu është përfshirë edhe në diskutimin mbi mundësinë e matjes dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet vendeve të ndryshme mbi migracionin. Me aprovimin e rregullores për vendet anëtare të BE përsa i përket migracionit, pritët që të kemi të dhëna sa më të plota e të sakta për emigrantët shqiptarë. Nga ana tjetër do të bëhen të gjitha përgatitjet e nevojshme për realizimin e Regjistrimit të Popullsisë për vitin 2011.

3. Nga detyrimet që do të rrjedhin nga ky Program Statistikor si dhe nga projekti i Qeverisë për Informatizimin e zyrrave të Gjëndjeve Civile, do të kemi informacione më të plota dhe më të sakta përsa i përket ngjarjeve demografike, të cilat do të na shërbejnë për përlllogaritjen më të mirë të popullsisë në shkallë vendi dhe rajonesh.

## **2.4 Burimet**

Me burimet e brendshme aktuale njerëzore mund të mbulohen të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me demografinë.

Për kryerjen e Regjistrimit të përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave 2011, do të ngrihet një strukturë e re, e cila do të mbulojë të gjitha fazat e regjistrimit

## 3. STATISTIKAT SOCIALE

32	Tregu i Punës	2006	2007	2008	2009	2010	2011
32101	Të dhëna administrative rreth punësimit dhe pagave	x	x	x	x	x	x
32102	Të dhëna administrative rreth papunesisë	x	x	x	x	x	x
32103	Vrojtimi i forcave të punës		x	x	x	y	y
33	Arsimi						
33101	Arsimi parashkollor	x	x	x	x	x	x
33201	Arsimi 8 vjeçar	x	x	x	x	x	x
33301	Arsimi i mesëm	x	x	x	x	x	x
33401	Arsimi i lartë	x	x	x	x	x	x
33501	Statistika ekonomike të arsimit publik	x	x	x	x	x	x
33601	Arsimi nga anketa		y	y	y	y	y
34	Kultura						
34101	Institucione që japin shfaqje	x	x	x	x	x	x
34201	Muze, monumente culture *)						
34301	Biblioteka						
34401	Operatore radio televizive	x	x	x	x	x	x
34501	Galeri artesh						
34601	Sporti						
35	Shëndeti						
35101	Aktiviteti Shëndetësor në Institucionet të shërbimit Parësor	x	x	x	x	x	x
35201	Aktiviteti i Shërbimit Dytësor ose Spitalor	x	x	x	x	x	x
35301	Shkaqet e vdekjeve sipas skedës për vdekjet mbi një vjeç.	x	x	x	x	x	x
35302	Shkaqet e vdekjeve për vdekjet e fëmijve nën 1 vjeç	x	x	x	x	x	x
36	Shpërndarja e të ardhurave dhe kushtet e jetesës						
36101	Anketa e matjes së nivelit të jetesës pranë familjeve			z			
36201	Anketa e buxhetit të familjes		x			z	
37	Mbrojtja sociale	x	x	x	x	x	x
37101	Mbrojtja sociale	x	x	x	x	x	x
38	Të tjera sociale						
38101	Divorcet	x	x	x	x	x	x
38401	Çështjet penale dhe civile, gjykata e shkallës së parë	x	x	x	x	x	x
38402	Çështjet penale dhe civile, gjykata e Apelit	x	x	x	x	x	x
38403	Çështjet penale dhe civile, Gjykata e Lartë	x	x	x	x	x	x
38501	Krimet dhe zbulimi i tyre	x	x	x	x	x	x
38601	Të dënuarit	x	x	x	x	x	x

**x-** indikatorët aktuale

**y-** nevojë për burime shtesë

**z-** mungesë burimesh

\*) Deri tani nuk kemi gjetur mundësinë e mbledhjes së këtyre treguesve

### 3.1 Objektivat e programit për statistikat sociale

**Tregu i punës** mbledh, përpunon, analizon dhe shpërndan të dhënat administrative për Tregun e Punës, mbrojtjen sociale dhe sigurimet shoqërore. Vrojtimi statistikor pranë familjes mbi forcën e punës është burimi që siguron informacion të plotë mbi punësimin dhe papunësinë jo vetëm në sektorin publik por edhe në atë privat bujqësor dhe jobujqësor. Ky burim nuk mund të sigurojë informacion real mbi shkallën e kërkimit aktiv të punës, mënyrat e kërkimit dhe shkallën e inaktivitetit në tregun e punës të cilat kushtëzojnë direkt hartimin e politikave të duhura mbi punësimin dhe trainimin e të papunëve apo riintegrimin në tregun e punës të personave inaktive.

#### OBJEKTIVAT:

1. Përmirësimi i treguesve nga rekordi administrativ
2. Ndërtimi i grupit të treguesve statistikorë të punës, të harmonizuar me kërkesat e standartet ndërkombëtare të Eurostatit.
3. Vlerësimin sasior dhe dinamik të zhvillimeve të tregut të punës mbështetur në të dhënat e integruara nga burimet administrative dhe statistikore

#### Shëndetësia:

Sistemi Statistikor i Shëndetësisë, përmban një informacionin të gjërë që mblidhet nga Aktiviteti Shëndetësor Parësor (qendra shëndetësore, ambulance, poliklinika, konsultoren gruas e të fëmijës, shërbimi laboratorik etj) dhe nga Aktiviteti Shëndetësor Dytësor e Terciar ( institucionet me shtretër si spitale e maternitete). Një rëndësi të veçantë kanë statistikat që kanë të bëjnë me Invalidët, Shëndetin Publik dhe Sigurinë në punë, për krahasueshmërinë e të dhënave në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare kompetente (OBSh dhe OECD) dhe në garantimin e koncepteve, definicioneve dhe klasifikimeve bazë të statistikave mbi shëndetësinë.

#### OBJEKTIVAT:

1. Përmirësimi i cilësisë dhe plotshmërisë së statistikave të shëndetësisë (kujdesi parësor, dytësor dhe terciar), sipas moshës, gjinisë dhe vendbanimit.
2. Zëvendësimi i nomenklaturës së shkaqeve të vdekjeve të ICD-9 me ICD-10, e cila jo vetëm do të unifikonte metodologjinë e përlogaritjes së treguesve, por nga ana tjetër do t'i bënte ato të krahasueshme me vendet e tjera.

#### Arsimi:

Statistikat e arsimit sigurohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nëpërmjet rekordeve administrative. Ato mbulojnë të gjitha nivelet e arsimit dhe llogarisin tregues si për numrin e institucioneve arsimore ashtu edhe për numrin e nxënësve që ndjekin, kanë përfunduar apo kanë lënë pa mbatuar shkollën. Gjithashtu informacion jepet edhe për numrin e mësuesve dhe pedagogëve, shkallën e regjistrimit, etj.



**OBJEKTIVAT:**

1. Përmirësimi dhe pasurimi i vazhdueshëm i Indikatorëve të arsimit.
2. Prodhimi i Statistikave të arsimit, sipas standarteve dhe kërkesave metodologjike të Eurostatit e UNESCO-s.
3. Shtimi i gamës së të dhënave nga arsimit privat dhe pasqyrimi i tyre në tregues statistikorë.

**Shpërndarja e të ardhurave dhe kushtet e jetesës****OBJEKTIVAT:**

1. Matja në mënyrë të vazhdueshme e nivelit të jetesës së familjeve shqiptare për të bërë të mundur hartimin e politikave dhe monitorimin e efekteve të tyre në përmirësimin e standartit të kushteve të jetesës, veçanërisht për identifikimin dhe targetimin e segmenteve më problematike në këtë drejtim.
2. Matja e konsumit final të familjeve dhe përqindja që zënë ndaj totalit, 12 grupet kryesore dhe zërat e veçantë sipas nomenklaturës së unifikuar europiane NPK (BE, 2003) sipas qëllimit. Kjo matje përveç rëndësisë që përmban në vetvete si një tregues i rëndësishëm statistikor do të bëjë gjithashtu të mundur:
  - Inserimin e konsumit final të familjeve si një vlerë reale në llogaritjen e PBB.
  - Sigurimin e të dhënave në nivel vendi lidhur me çmimet e mallrave të konsumit në nivel të disagreguar për të mundësuar azhiornimin e IKK.
3. Matja e të ardhurave dhe ndarja e tyre sipas strukturës duke mundësuar llogaritjen e indikatorëve në linjë me vendet europiane dhe të rajonit për të matur mirëqënien dhe varfërinë në vend.

**Indikatorët që prodhohen aktualisht****Tregu i punës**

Aktualisht, të dhënat zyrtare mbi punësimin, papunësinë dhe popullsinë inaktive në Shqipëri bazohen në të dhënat administrative. Informacioni mbi punësimin bazohet kryesisht në deklaratimet e ndërmarrjeve dhe vlerësime nga burime alternative si Rregjistrimi i Popullsisë dhe Banesave apo Vrojtimi e Matjes së Nivelit të Jetesës, ndërsa informacioni mbi papunësinë bazohet në informacionin e marrë nga Zyrat e Punës rreth papunësisë së rregjistruar. Megjithatë të dhënat mbi punësimin janë të detajuara dhe relativisht të plota vetëm për sektorin publik. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sektorin privat bujqësor dhe jo-bujqësor. Informacioni mbi papunësinë e rregjistruar mbulon vetëm personat e rregjistruar si të papunë në to.

## Shëndetësia

Sistemi statistikor i shëndetësisë përmban një informacion të gjërë dhe përlogarit tregues që mbliidhen nga Ministria e Shëndetësisë sipas:

Aktiviteti shëndetësor parësor (qendra shëndetësore, ambulanca, konsultori i gruas dhe fëmijës, shërbimi laboratorik, etj.)

Aktiviteti shëndetësor dytësor dhe terciar (institucionet me shtretër si spitale e maternitete)

Statistika të invalidëve, shëndetit publik dhe shëndetit dhe sigurisë në punë.

## Arsimi

Burimi i të dhënave të statistikave të arsimit është Ministria e Arsimit dhe Shkencës nga e cila përlogariten tregues (sipas klasifikimit ndërkombëtar standart të arsimit, i cili është aplikuar edhe në sistemin tonë – ISCED-97) sipas:

Niveleve të arsimit (parashkollor, të arsimit bazë, të arsimit të mesëm dhe atij të lartë). Këta tregues përlogariten sipas gjinisë, grupmoshave, vendbanimit dhe ndarjes qytet-fshat.

Sipas këtyre niveleve përlogariten tregues që kanë të bëjnë me numrin e institucioneve arsimore, të regjistruar, të diplomuar, mësues dhe edukatorë, staf akademik.

## Shpërndarja e të ardhurave dhe kushtet e jetesës

Të dhënat mbi nivelin e jetesës janë marrë deri më sot nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës e cila e konceptuar si një anketë shumëqëllimshme bën të mundur nxjerrjen e indikatorëve që përshkruajnë të gjitha aspektet e jetës së familjeve duke filluar nga konsumi ushqimor dhe jo-ushqimor, arsimi, shëndeti, punësimi, migrimi, shërbimet bazë (utilitetet) banesën, të ardhurat nga puna dhe asistenca sociale, transfertat brenda dhe jashtë vendit, mirëqenia subjektive dhe kapitali social. Kjo anketë siguron të dhëna që i shërbejnë një pjesë të madhe të degëve të prodhimit të statistikave por aktualisht nuk ka një vazhdimësi të siguar nga ana financiare për periudhën 2007-2011.

### 3.3 Rezultatet e pritshme për 2011

#### Tregu i punës

1. Ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të statistikave të forcave të punës sipas standarteve të Eurostat-it
2. Të ngrejë mekanizmat praktike për kryerjen e vrojtimit mbi forcën e punës në mënyrë periodike.
3. Të ndjekë zhvillimet në tregun shqiptar të punës duke siguruar matjen në vijimësi të treguesve të përmirësuar.
4. T'u sigurojë hartuesve të politikave informacion më të plotë të nevojitur për përmirësimin e politikave ekonomike e sociale.

5. T'u sigurojë përdoruesve të ndryshëm dhe organizatave ndërkombëtare informacion më të plotë mbi treguesit e punës në Shqipëri.

### **Shëndetësia**

1. Standartizimin dhe implementimin progresiv të metodologjisë së punës sipas kërkesave të Eurostatit
2. Sigurimin e serive kohore dhe zgjerimi i treguesve për statistikat e shëndetësisë për "Shëndet për të gjithë" sipas OBSH.

### **Arsimi**

1. Futja për herë të parë në program e llogaritjes së Raportit Neto të Regjistrimeve në arsim.
2. Llogaritja e Indikatorëve të rinj në rastin e kryerjes së ndonjë vrojtimi statistikor specifik për arsimin, ose shtimit të të dhënave nga burimi.
3. Azhornimi në kohë me përmirsimet e ISCED 97 dhe studimi i mundësisë për implementimin e shpejtë të tyre.

### **Shpërndarja e të ardhurave dhe kushtet e jetesës**

Realizimi i Anketës së Buxhetit të Familjes 2006-2007, për herë të parë në nivel vendi do të bëjë të mundur llogaritjen e indikatorëve përkatës sipas standarteve europiane por për të qënë në harmoni të plotë me këtë standart është e nevojshme që të përsëritet çdo tre vjet (pra të fillojë përgatitja e saj për hedhjen në terren gjatë periudhës 2009-2010). Kjo anketë do të mundësojë njëkohësisht informacionin lidhur me konsumin dhe të ardhurat e familjes si indikatorë të matjes së nivelit të jetesës dhe azhornimin e NPK-së dhe konsumin final të familjeve si pjesë e PBB.

Në të njëjtën kohë nëse do të mundësohej një vazhdimësi e Anketës së Nivelit të Jetesës pranë familjeve (në 2008) do të ruhej vazhdimësia e gjithë indikatorëve socialë të përmendur më lart dhe do të sigurohej monitorimi i nivelit të jetesës dhe varfërisë në vend si rezultat i aplikimit të politikave për këtë qëllim.

### **Burimet**

Me burimet e brendëshme njerëzore deri tani kemi përballuar pothuaj të gjitha statistikat sociale. Me fillimin e anketës së Forcave të punës na nevojiten akoma edhe 3 persona për të përballuar me sukses këtë detyrë.

## Statistikat Makro - Ekonomike

40	Statistikat Makro-Ekonomike	2006	2007	2008	2009	2010	2011
40201	Prodhimi dhe vlera e shtuar e degës së Ndërtimit me çmime korente dhe konstante	X	X	X	X <sup>1</sup>	X	X
40202	Konsumi final i administratës publike, me çmime korrente e konstante	X	X	X <sup>2</sup>	X	X	X
40203	Prodhimi dhe Vlera e shtuar e Administratës Publike, IJFP, Arsim, Shëndetësi, me çmime korrente e konstante	X	X	X <sup>2</sup>	X	X	X
40204	Vlerësimi i formimit bruto të kapitalit fiks me çmime korente dhe konstante	X	X	X	X	X	X
40205	Vlerësimi i ndryshimit të gjendjeve me çmime korrente e konstante						
40206	Vlerësimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit funksional	X	X	X	X	X	X
40207	Llogaritja e taksave mbi produktet, me çmime korrente e konstante	X	X	X <sup>2</sup>	X	X	X
40208	Llogaritja e subvencioneve mbi produktet, me çmime korrente e konstante	X	X	X <sup>2</sup>	X	X	X
40209	Prodhimi dhe vlera e shtuar për aktivitetin e sigurimeve, me çmime korrente e konstante	X	X	X	X	X	X
40210	Vlerësime për ekonominë e pavrojtuar, me çmime korrente e konstante	X	X	X <sup>3</sup>	X	X	X
40211	Vlerësim për njohjen e strukturës së konsumit ndërmjetës	X	X	X	X	X	X
40212	Vlerësimi i prodhimit e vlerës së shtuar për institucionet financiare, me çmime korente e konstante	X	X	X	X	X	X
40213	Vlerësimi i shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matura indirekt (FISIM-Angl.)	X	X	X	X	X	X <sup>4</sup>
40214	Prodhimi dhe vlera e shtuar e industrisë me çmime korrente e çmime konstante	X	X	X	X	X	X
40215	Prodhimi, konsumi ndërmjetës e vlera e shtuar në degën e bujqësisë, pyje e peshkim	X	X	X	X	X	X
40216	Eksporti Neto, me çmime korrente e konstante	X	X	X	X	X	X

<sup>1</sup> Përmirësime cilësore si rezultat i aplikimit të Indeksit të ri të kostos në ndërtim

<sup>2</sup> Përmirësime cilësore si rezultat i funksionimit On-line të data base në Ministrinë e Financave. Përgatitje për kalimin nga cash basis në accrual basis.

<sup>3</sup> Do të intensifikohet aktiviteti duke përdorur të dhënat e vrojtimit mbi Fuqinë Punëtore (pranë familjeve) dhe burime të tjera nga statistikat e ndërmarrjeve

<sup>4</sup> Përgatitje për një revizionim të serisë të shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matura indirekt: shpërndarja e tij sipas sektorëve përdorues, në zbatim të rekomandimeve të dhëna për adoptimin e rregullores të Këshillit të Bashkimit Europian, nr. 448/98.

40217	Konsumi Final i Popullatës me çmime korrente e konstante	X	X	X <sup>5</sup>	X	X	X
40218	Vlera e Shtuar Bruto me çmimet baze dhe PPB, me çmimet e tregut, sipas metodës së prodhimit	X	X	X	X	X	X
40219	PBB sipas metodës së shpenzimeve						
40220	Prodhimi dhe Vlera e shtuar e degës: Tregëti, Hotele, me çmime korrente e konstante	X	X	X	X	X	X
40221	Prodhimi dhe vlera e shtuar e degës së Transportit me çmime korrente dhe konstante	X	X	X	X	X	X
40222	Prodhimi dhe vlera e shtuar e degës Post-Komunikacionit me çmime korrente dhe konstante	X	X	X	X	X	X
40223	Prodhimi dhe vlera e shtuar e Shërbimeve të tjera, me çmime korrente dhe konstante	X	X	X <sup>2</sup>	X	X	X
40224	Vlerësim për Konsumin Final të Institucioneve Jo Fitim Prurëse, me çmime korrente dhe konstante	X	X	X	X	X <sup>6</sup>	X
41	Llogaritë 3 mujore						
41101	Ndryshimet në PBB tremujore			X	X	X	X

x- indikatorët aktualë

y- nevojë për burime shtesë

z- mungesë burimesh

### 3.1 Objektivat e programit për statistikave makro

- Përmirësimi i statistikave makro-ekonomike nëpërmjet përmirësimit të treguesve egzistues
- Hartimi i treguesve të rinj në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin e EU
- Publikimi në vitin 2008 i disa statistikave makro-ekonomike tremujore
- Përmirësimi i statistikave makro dhe përafrimi gjithnjë e më shumë i tyre me statistikave të EU

Programi 2007-2011 rikonfirmon dhe perforcon objektivat e vëna sektorit të LLK lidhur me konsolidimin e vlerësimeve vjetore, për përmirësimin e cilësisë të informacionit nëpërmjet analizave cilësore të të dhënave individuale.

Vëmendje e veçantë i kushtohet përgatitjes për një rishikim të serive kohore të statistikave makro-ekonomike, që do të ketë efekt sidomos pas vitit 2008, kur midis të tjerash, do të shfrytëzohen në shumë drejtime, të dhënat e dala nga Vrojtimi i Buxhetit të Familjeve (HBS). Zhvillimi i statistikave pranë familjeve do të krijojë mundësi më të gjëra për përmirësimet që priten në vlerësimin e PBB me metodën e shpenzimeve. Efektet do të pasqyrohen sidomos në vlerësimet më cilësore për:

<sup>5</sup> Përmirësim cilësor i treguesit si rezultat i përdorimit të të dhënave nga Vrojtimi i Buxhetit të Familjeve si dhe i shfrytëzimit të variablave të rinj nga burimet e statistikave të ndërmarrjeve tregëtare

<sup>6</sup> Rivlerësim i këtij treguesi, mbështetur në vërtetimin specifik të propozuar për Institucionet Jo Fitim Prurëse

- treguesin e Konsumit Final të Popullatës, që në ndryshim nga mënyra aktuale e llogaritjes, si diferencë, do të vlerësohet drejtpërdrejt me burime statistikore dhe këto duke respektuar në maksimum kërkesat e nomenklaturës përkatëse (COICOP Angl.).
- treguesin e qerasë të imputuar, etj.

Në fushën e vlerësimeve të Ekonomisë së Fshehur, do të ndërmerren një seri aksionesh, që janë të lidhura me shfrytëzimin e të dhënave nga vrojtimi i organizuar nga INSTAT, për Forcat e punës, financuar nga Buxheti i Shtetit. Në këto vlerësime, do të ketë një përdorim më të mirë metoda e llogaritjeve mbi inputet e punës.

Do të avancohet më tej në përmirësimin e llogaritjes me çmime konstante, nga ku pritet të vlerësohet më mirë një nga treguesit më kryesorë makro-ekonomikë, siç është ai i rritjes ekonomike të vendit. Kjo do të bëhet e mundur nëpërmjet aplikimit më të mirë të metodës së deflatimit të dyfishtë, duke shfrytëzuar të dhënat që do të dalin nga vrojtimi pranë ndërmarrjeve për njohjen e strukturës të konsumit ndërmjetës, sipas degëve të origjinës.

Parashikohet përfundimi dhe përpunimi më cilësor i të dhënave tremujore për efekt të sektorit institucional të administratës publike, duke shfrytëzuar mundësitë që krijohen nga sistemi on-line që do t'i vihet në dispozicion INSTAT nga ana e Ministrisë së Financave.

Do të kryhen testimet finale në lidhje me cilësinë e statistikave makro-ekonomike tremujore dhe do të konsiderohet publikimi i tyre në vitin 2008.

Në kufijtë e këtyre viteve të programit të paraqitur, paralelisht me avancimet në kontabilitetin publik, do të kryhen studimet përkatëse për kalimin nga metoda CASH BASIS, aktualisht e përdorur në llogaritjet për Administratën Publike, në metodën ACCRUAL BASIS, si një nga kërkesat metodike që paraqet aplikimi i standarteve europiane (ESA-95).

Do të bëhen përpjekje më intensive, për ndërtimin e Tabelës Burime Përdorime, duke përdorur në mënyrë të integruar të dhënat që do të ofrohen nga burimet statistikore pranë ndërmarrjeve të parashikuara në këtë program, në nivel produkti, që lidhen si me prodhimin ashtu dhe me përdorimin e tyre. Parashikohet në këtë kuadër një aplikim me më efekt i metodës Commodity Flow, si një nga metodat më kryesore për ballancimet ekonomike.

### **3.2. Indikatorët që prodhohen aktualisht**

#### **Situata aktuale**

Sistemi i treguesve ekonomikë të Shqipërisë është përmirësuar në dekadën e fundit, edhe falë bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare. Më specifikisht, në mes të vitit 1999 INSTAT nisi të zhvillojë vlerësimet e PBB-së bazuar në metodologjinë e SNA 1993. Në fund të vitit 2002, vlerësimet e para të PBB-së për periudhën 1996-2000 të kryera me asistencën teknike të FMN-së ishin të disponueshme dhe më në fund u publikuan në janar të vitit 2003. Krahasuar me publikimet e mëparshme të llogarive kombëtare, vlerësimi i PBB-së i vitit 2003 është më tepër i harmonizuar me standartet SNA 1993, ndërsa perputhja e plotë me kërkesat ESA 1995, do të jetë objekt në vitet e mëpasme. Këtij objektiv i shërbeu edhe projekti i binjakëzimit mes INSTAT dhe tre zyrave të statistikave, Itali, Finlandë dhe Hungari, i financuar bashkarisht nga EU dhe FMN.

Në kuadrin e këtij projekti gjithashtu u realizuan trainime për të prezantuar zhvillimet metodike dhe për të shpërndarë njohuritë e përgjithshme mbi llogaritë kombëtare, si për specialistët brenda dhe jashtë INSTAT-it, ashtu edhe për përdoruesit kryesisht nga institucionet qëndrore.

Vlerësimet me çmimet korrente të vlerës së shtuar të prodhuar në bujqësi u integruan me informacionin mbi çmimet e prodhimit dhe sasitë fizike të prodhuara. Kjo mënyrë krijoi mundësinë për ndertimin e sistemit të llogarive me çmime konstante.

Njësoj si bujqësia, edhe ndërtimi si një degë strategjike aktiviteti në ekonominë shqiptare, i u nenshtrua një analize më të thellë si nga ana e kërkesës ashtu dhe ofertës. Kjo analizë ka nxjerrë në pah disa të meta që kanë penguar përpilimin e llogarisë burime-përdorime për këtë sektor. Si pasojë, u hartuan të dhëna të reja mbi formimin bruto të kapitalit fiks. Këto të dhëna u bazuan kryesisht mbi statistikat ASVN dhe LSMS. Kjo analizë ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në forcimin e kufizimeve të përmbajtjes mes komponentëve të kërkesës dhe ofertës së llogaritjeve makro-ekonomike.

Dobësitë kryesorë të përpilimit të llogarive kombëtare të Shqipërisë kanë lidhje me komponentin e kërkesës dhe në veçanti me vlerësimet e konsumit familjar. Me qëllim shmangien e kësaj të mete u implementua një procedurë e re për të vlerësuar konsumin përfundimtar. Pikënisja e procedurës së përdorur në rivlerësimet e të dhënave ekonomike që kanë lidhje me konsumin përfundimtar familjar është përdorimi i hipotezës që PBB-ja (ose Output ) duhet të marrë vlerën e llogaritur me anë të metodës së prodhimit,

U vu në zbatim edhe një metodë me qëllim që të shqyrtojë mundësinë e implementimit të metodologjisë për futjen e sistemit të deflatimit të dyfishtë dhe duke deflatuar konsumet ndërmjetëse përpjestimisht me mesataret e çmimeve të lendeve të para e materiale të importuara dhe atyre të prodhuara në vend. Deri tani, INSTAT ka deflatuar vlerën e shtuar duke përdorur tregues të thjeshtë, kryesisht të ardhur nga indekset e çmimevet vendase ose nga indekse të pagave.

### **3.3 Rezultatet e pritshme për 2011**

Sektori i llogarive kombëtare që merret me llogaritjen e statistikave makro –ekonomike deri në fund të vitit 2011 ka si objektiv vazhdimin e publikimit të treguesve ekzistues duke përmirësuar cilësinë e llogaritjes së tyre si dhe shtimin e disa treguesve të tjere në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin e EU.

Duke marrë parasysh kërkesën gjithnjë e në rritje të përdoruesve vendas dhe të huaj për të pasur statistika makroekonomike të shpejta në kohë, si edhe kriteret për plotësimin e Standardeve Speciale të Shpërndarjes të të Dhënave (SDDS), INSTAT ka planifikuar që në vitin 2008 të publikojë disa statistika të llogarive kombëtare tremujore. Treguesit që INSTAT beson që mund të jenë të gatshëm për publikim në vitin 2008 janë:

- Ndryshimet (%) në Vlerat e Shtuara tremujore sipas shtatë sektorëve kryesorë të ekonomisë, si dhe në PBB tremujor, me çmime korrente të parregulluara e të rregulluara sezonalisht
- Ndryshimet (%) në Vlerat e Shtuara tremujore sipas shtatë sektorëve kryesorë të ekonomisë, si dhe në PBB tremujor, në terma volumi (çmimet e një viti më parë) të parregulluara e të rregulluara sezonalisht

Prej rreth dy vitesh INSTAT ka vlerësuar në mënyrë eksperimentale statistikat e sipër përmendura dhe gjatë gjithë kësaj periudhe INSTAT ka fituar një eksperience të konsiderueshme në përpilimin e tyre dhe i ka përmirësuar vazhdimisht ato. INSTAT, me ndihmën e eksperteve të huaj ka identifikuar problemet kryesorë të këtij produkti të ri statistikor, si në aspektin e burimeve të të dhënave, ashtu dhe në aspektin teknik dhe gjatë kësaj kohe është punuar dhe po punohet sistematikisht për kapërcimin e

këtyre pengesave. INSTAT beson që treguesit të cilët do të publikohen në vitin 2008 do të plotësojnë të gjitha standardet e duhura të cilësisë, për të qenë të denja për përdoruesin.

Me publikimin e këtyre statistikave të llogarive makroekonomike afatshkurtra, Shqipëria përmbush dhe një nga kërkesat kryesore për plotësimin e Standardeve Speciale të Shpërndarjes të të Dhënave (SDDS).

Deri në vitin 2011, me përmirësimin e burimeve dhe konsolidimin e mëtejshëm të llogarive kombëtare vjetore, pretendojmë që llogarite kombëtare tremujore të shkojnë gjithnjë e më tepër drejt standardeve të BE, duke u pasuruar me tregues të tjerë, si dhe duke përmirësuar akoma më tepër cilësinë e tyre e sidomos dy nga karakteristikat kryesore të cilësisë siç janë, saktësia dhe koha sa më e shkurtër e vlerësimit të tyre.



## 4. STATISTIKAT E NDERMARRJEVE

44	Statistikat e ndërmarrjeve	2006	2007	2008	2009	2010	2011
44101	Anketa strukturore pranë ndërmarrjeve	x	x	x	x <sup>1</sup>	x	x
44102	Investimet e realizuara	x	x	x	x	x	x
44401	Anketa tremujore pranë ndërmarrjeve të industrisë	x	x	x	x	x	x
44402	Vrojtimi tremujor pranë ndërmarrjeve të ndërtimit	x	x	x	x	x	x
44403	Vrojtimi tremujore pranë ndërmarrjeve të transportit	x	x	x	x	x	x
44404	Vrojtimi me zgjedhje pranë ndërmarrjeve të tregtisë	x	x	x	x	x	x
44405	Vrojtimi tremujor pranë hoteleve	x	x	x	x	x	x
44406	Tregues të lejeve të ndërtimit	x	x	x	x	x	x
44407	Të dhëna administrative për Industrinë	x	x	x	x	x	x
44408	Indeksi i shitjeve	x	x	x	x	x	x
45	Energjia						
45101	Bilanci Kombëtar i Energjise	x	x	x	x	x	x
45201	Bilanci i energjise elektrike	x	x	x	x	x	x
48	Transport						
48101	Inventari i mjeteve të transportit rrugor	x	x	x	x	x	x
48201	Transporti rrugor urban i udhëtarëve	x	x	x	x	x	x
48401	Rrjeti hekurudhor	x	x	x	x	x	x
48402	Transporti hekurudhor	x	x	x	x	x	x
48501	Transporti detar i udhëtarëve, mjeteve dhe mallrave	x	x	x	x	x	x
48600	Transporti ajror	x	x	x	x	x	x
48801	Aksidente në qarkullimin rrugor	x	x	x	x	x	x
48901	Transport me tubacion	x	x	x	x	x	x
49		x	x	x	x	x	x
49201	Aktiviteti i shërbimit postar	x	x	x	x	x	x
49301	Aktiviteti i shërbimit telefonik fiks	x	x	x	x	x	x
49401	Aktiviteti i shërbimit të telefonisë celulare	x	x	x	x	x	x
49501	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit			y	y	y	y

<sup>1</sup> Në këtë vit, nëse ka hyrë në fuqi ligji për planin e ri kontabël, do të hidhet në teren anketa e re për statistikën strukturore të ndërmarrjeve, e cila do pasqyrojë ndryshimet sipas ligjit si dhe mbulimin e plotë të kërkesave të EU për statistikën strukturore të biznesit.

50	Turizmi	x	x	x	x	x	x
50101	Kapaciteti dhe frekuentimi i hoteleve	x	x	x	x	x	x
50201	Hyrjet dhe daljet e shtetesave shqiptarë dhe të huaj ne pikat kufitare	x	x	x	x	x	x
51	Regjistri i ndërmarrjeve						
51101	Regjistri statistikor i ndërmarrjeve ekonomike jo-bujqësore	x	x	x	x	x	x <sup>2</sup>
51102	Anketa pranë ndërmarrjeve të reja	x	x	x	x	x	x

**x-** indikatorët aktualë

**y-** nevojë për burime shtesë

**z-** mungesë burimesh

#### 4.1.1 Objektivat e programit për statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve

Objektivat e programit për statistikat ekonomike të ndërmarrjeve është përmirësimi i cilësisë së statistikave duke përdorur të gjitha burimet e mundshme të informacionit për të prodhuar statistika sa më të përshtashme dhe në kohë.

Llogaritja e të gjithë treguesve mbi STS për të qëndruar në një drejtim me Rregulloren e Eurostatit 1165/98.

#### 4.2.1 Indikatorët që prodhohen aktualisht nga statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve

- **Vrojtimi tremujor**

Prodhimi në ndërmarrjet me 10 dhe më shumë të punësuar në Industri, Ndërtim, periudhë tremujore

Shifra e afarizmit në ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar në Industri, Ndërtim, Transport, Komunikacion, Tregti me shumicë (bazuar në realizimin e shifrës së afarizmit), Tregti me Pakicë (me zgjedhje ndërmarrjesh dhe ekzostiv) dhe Hotele (me 5 dhoma e më shumë).

Numri i të punësuarve gjithsej në Industri, Ndërtim, Tregti me pakicë dhe shumicë, Hotele, Transport dhe Komunikacion, në periudha tremujore.

Numri i të punësuarve gjithsej në Industri, Ndërtim, Tregti me pakicë dhe shumicë, Hotele, Transport dhe Komunikacion, në periudha tremujore.

Fondi i pagave në Industri, Ndërtim, Tregti me pakicë dhe shumicë, Hotele, Transport dhe Komunikacion, në periudha tremujore.

Orët e punës në ditë në Industri dhe Ndërtim, në periudhë tremujore.

Ditët e punës në javë në Industri, në periudhë tremujore.

Tregues specifikë në Hotele dhe Ndërtim në periudhë tremujore.

<sup>2</sup> Në këtë vit do të përfundojë edhe hartimi i regjistrit të njësive lokale

- **Burime administrative**

Lejet e ndërtimit sipas tipit të objektit në numër, sipërfaqe dhe vlerë.

Fondi i parashikuar për objektin që miratohet sipas lejeve të ndërtimit sipas tipit të klientit.

Prodhimi mall i shitur në periudhë tremujore dhe progresive nga ministrinë për ndërmarrjet në varësi të tyre.

Produktet industriale në natyrë në periudhë tremujore dhe progresive nga ministrinë për ndërmarrjet në varësi të tyre.

Numri i automjeteve të transportit rrugor.

Numri i automjeteve të transportit rrugor sipas rretheve

Vëllimi i punës në transportin rrugor urban të udhëtarëve.

Gjatësia e linjave hekurudhore

Volumi i punës në transportin hekurudhor

Transporti hekurudhor sipas llojit të mallrave

Transporti detar i udhëtarëve

Transporti detar i mallrave

Volumi i ngarkim-shkarkimit

Transporti ajror i mallrave, pasagjerë, posta

Aksidente në qarkullimin rrugor

Aksidente në qarkullimin rrugor sipas llojit të aksidentit

Aksidente sipas gjinisë

Transporti me tubacione

Aktiviteti i shërbimit postar

Aktiviteti i shërbimit të telefonisë fikse sipas rretheve

Aktiviteti i shërbimit të telefonisë celulare

Hyrjet dhe daljet e shtetasve të huaj dhe shqiptare në kufi

Investimet gjithsej dhe sipas strukturës.

#### **4.3.1 Rezultatet e pritshme për 2011 për statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve**

Sektori i statistikave të ndërmarrjeve deri në fund të vitit 2011 ka si objektiv vazhdimin e publikimit të treguesve ekzistues duke përmirësuar cilësinë e llogaritjes së tyre, afatin e publikimit si dhe shtimin e disa treguesve të tjere në përputhje me rregulloren 1165/98 të EU në përputhje me metodologjinë përkatëse.

Ky sektor ka për qëllim të kërkojë informacion mbi teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në ndërmarrjet ekonomike nëpërmjet një vrojtimi vjetor.

#### **4.1.2 Objektivat e programit për Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve**

Qëllimi kryesor i statistikave strukturore të ndërmarrjeve është të tregojë strukturën e aktiviteteve ekonomike nëpërmjet të dhënave ekonomike Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Këto statistika përfshijnë gjithë ndërmarrjet jobujqësore aktive në Shqipëri për të gjitha format legale (Nuk përfshihen aktivitetet financiare, arsimit, shëndetsia e kultura).

#### **4.2.2 Indikatorët që prodhohen aktualisht nga Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve**

Indikatorët kryesorë paraqesin

- Të dhëna demografike të ndërmarrjeve
- Aktiviteti ekonomik të detajuar në nivel NVE 2 shifror
- Punësimi
- Tregues financiare
- Investimet
- Tregues specifik të degëve

#### **4.3.2 Rezultatet e pritshme për 2011 për Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve**

- Rishikimi i pyetsorit në vartësi të ligjit të ri mbi Planin Kontabël dhe rregullores së Eurostat.
- Sigurimi i një cilësie më të mirë të të dhënave nëpërmjet trajnimeve të specialistëve dhe anketuesve
- Plotësimin më të mirë të kërkesave të përdoruesve

#### **4.1.3 Objektivat e programit për Regjistrin e Ndërmarrjeve**

INSTAT krijon, mirëmban dhe është përgjegjës për regjistrin statistikor të ndërmarrjeve

Qëllimi i regjistrin statistikor të ndërmarrjeve është dallimi dhe ndërtimi i njësive statistikore – ndërmarrjet dhe shërben si mjet për të realizuar vrojtime, për përgatitjen dhe koordinimin e studimeve, për grupimin e rezultateve të studimeve. Ai është burim informacioni për analizat statistikore të popullatës së biznesit dhe demografinë e saj.

#### **4.2.3 Indikatorët që prodhohen aktualisht nga Regjistri i Ndërmarrjeve**

Regjistri statistikor i ndërmarrjeve ndjek si indikatorë më të rëndësishëm:

- Ndryshimet demografike

- Tregues identifikues si emri i firmës, emri i pronarit etj.
- Vendndodhja
- Forma legale
- Pronësia
- Aktivitetin që kryen
- Të punësuarit

#### **4.3.3 Rezultatet e pritshme për 2011 për Regjistrin e Ndërmarrjeve**

- Përgatitja e regjistrit statistikor të ndërmarrjeve në përputhje me kërkesat e EU
- Përgatitja e regjistrit statistikor të njësive lokale në përputhje me kërkesat e EU
- Përgatitja e regjistrit statistikor me të dhëna ekonomike në seri kohore
- Standartizimi i rubrikës mbi demografinë e ndërmarrjeve si pjesë e anketave të ndryshme dhe që shërben për përditësimin e Regjistrit të Ndërmarrjeve

#### **4.4 Resource**

- **Për Regjistrin e Ndërmarrjeve** - për momentin punojnë 3 specialistë dhe deri në fund të vitit 2011 nuk ka kërkesë për shtesë të burimeve njerëzore. Pas vitit 2011 do të duhet shtesë personeli për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave në proces dhe të rinj.

**5. STATISTIKAT MONETARE, FINANCIARE, TË TREGTISË SË JASHTME DHE BOP**

52	Paraja dhe financa	2006	2007	2008	2009	2010	2011
52301	Kredia për ekonominë	x	x	x	x	x	x
52302	Agregatët e parasë	x	x	x	x	x	x
52302_1	Paraqitja e Bankës së Shqipërisë		x	x	x	x	x
52302_2	Paraqitja e korporatave të tjera depozituese		x	x	x	x	x
52302_3	Paraqitja e korporatave depozituese		x	x	x	x	x
53	Tregtia e mallrave						
53101	Prodhimi statistikave të tregtisë së mallrave	x	x	x	x	x	x
53101	Prodhimi statistikave të tregtisë së mallrave	x	x	x	x	x	x
54	Tregu dhe BOP						
54201	Përpilimi i bilancit të pagesave	x	x	x	x	x	x
55	Çmimet						
55101	Çmimet e prodhimit	x	xy	xy	xy	xy	xy
55201	Çmimet e konsumit	x	x	x	x	x	x
55301	Çmimet e ndërtimit	x	x	x	x	x	x
55401	Vrojtim mbi Barazinë e fuqisë blerëse	x	x	x	x	x	x

**5.1 Objektivat e programit për statistikat monetare**

- Përmirësimi i statistikave monetare nëpërmjet përmirësimit të treguesve egzistues
- Hartimi i treguesve të rinje në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin e EU
- Konturimi më i plotë dhe afatgjatë i statistikave monetare

**5.2. Indikatorët që prodhohen aktualisht****Statistikat e çmimeve**

Statistikat e çmimeve kanë si detyrë të ofrojnë të dhëna për çmimet me pakicë të produkteve, çmimeve të prodhimit të mallrave industriale dhe produkteve bujqësore, çmimeve të materialeve të ndërtimit. Për prezantimin e dinamikës së çmimeve, llogariten indekset e ndryshme të çmimeve si Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (banesa), ku më i rëndësishmi është Indeksi i Çmimeve të Konsumit, i cili përdoret aktualisht si matës i inflacionit.)

**Statistikat e tregtisë së mallrave**

Statistikat e tregtisë së mallrave kanë si qëllim të ofrojnë të dhëna mbi tregtinë, eksport-importin, e mallrave në Shqipëri. Për këtë qëllim statistikat e tregtisë së mallrave llogarisin treguesit e eksportit

Shënim: y\* indeksi i çmimeve të prodhimit për eksport është rezultat i përmirësimit të Indeksit të çmimeve të Prodhimit. Duke filluar nga viti 2007 ky indeks do llogaritet si Indeksi i Çmimeve të prodhimit për mallrat që tregtohen në vend dhe indeks për mallrat e eksportit. Llogaritja e këtij indeksi do të realizohet duke shfrytëzuar burimet ekzistuese.

(FOB) dhe importit (CIF) në total si dhe disa tregues të tjerë më të detajuar si psh. eksport/importi sipas vendeve, grupvendeve, grupmallrave, etj.

Burimi i sigurimit të të dhënave statistikore të tregtisë së jashtme të mallrave është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (burim administrative).

### **Statistikat monetare, financiare dhe BOP**

Institucioni përgjegjës për Përpilimit të Bilancit të Pagesave është Banka e Shqipërisë. Burimi i të dhënave janë të gjitha bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e kursim kreditimit, shoqëritë e sigurimeve, ambasadat dhe organizata jo qeveritare si dhe disa vrojtme që kryen nëpërmjet INSTAT-it si vrojtimi mbi turizmin dhe investimet e huaja direkte si dhe vrojtimi për remitancat.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për llogaritjen e treguesve monetarë si Kredia për ekonominë dhe Agregatet e parasë. Burimi i informacionit edhe për llogaritjen e këtyre treguesve janë bankat e nivelit të dytë ku raportojnë nëpërmjet Sistemit Raportues të Unifikuar.

### **5.3 Rezultatet e pritshme për 2011**

Sektorët që merren me llogaritjen e statistikave monetare, financiare, të tregtisë së jashtme dhe BOP deri në fund të vitit 2011 kanë si objektiv vazhdimin e publikimit të treguesve ekzistues duke përmirësuar cilësinë e llogaritjes së tyre si dhe shtimin e disa treguesve të tjerë në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin e EU.

#### **Për statistikave të çmimeve:**

- Me përfundimin e Anketës së Buxhetit të Familjeve do të përditësohen peshat e produkteve të Indeksit të Çmimeve të Konsumit.
- Duke filluar nga tremujori i parë 2007 do të fillojë puna për përditsimin e strukturës së peshave dhe produkteve të Indeksit të Çmimeve të prodhimit. Me përfundimin e revizionimit të këtij indeksi INSTAT do të llogarisë Indeksit të Çmimeve të Prodhimit për mallrat e eksportit. Për llogaritjen e këtij indeksi do të shfrytëzohen të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit për mallrat që tregtohen në vend dhe për mallrat e eksportit. Zgjerimi dhe përmirësimi i këtij indeksi do të jetë i mundur të përballohet me burimet ekzistuese.
- Në vitin 2008 do të fillojë puna për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Importit dhe Indeksit të Çmimeve të Shërbimeve. Këto janë dy tregues të rinj, llogaritja e të cilëve do të plotësojë më mirë tablonë e përgjithshme të statistikave të çmimeve si dhe janë të domosdoshëm për përmirësimin e statistikave të Sektorit të Llogarive Kombëtare.

Llogaritja e këtyre treguesve duhet të shoqërohet me burime financiare shtesë dhe shtesë stafi.

- Në vitin 2007 do të fillojë puna për azhurnimin e strukturës së peshave të ndërmarrjeve dhe produkteve të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për banesat). Njëkohësisht me azhurnimin e këtij indeksi do fillojmë llogaritjen e Indeksit të Kushtimit në Ndërtimit. Ky indeks tashmë do të pasqyrojë një panoramë të plotë të sektorit të ndërtimit dhe do të

përfshijë ndërtimin e banesave dhe punimet inxhinierike. Me llogaritjen e këtij treguesi plotësohen më mirë nevojat e Sektorit të Llogarive Kombëtare, për aktivitetin e ndërtimit.

## Burime

Llogaritja e këtij treguesi duhet të shoqërohet me burime financiare shtesë dhe shtesë stafi.

### 5.4. Burimet

Spektori i Çmimeve aktualisht ka tre persona. Secili prej tyre aktualisht mbulon një ose dy indekse. Me këto burime mendojmë të mbulojmë edhe zgjerimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit, për prodhimin për shitje brenda vendit dhe për eksport.

Zgjerimin dhe llogaritjen e treguesve të tjerë të rinj të përmendur më lart duhet shoqëruar me burime financiare shtesë dhe staf i ri.

#### Treguesit e rinj për të cilët nevojitet shtesë stafi dhe burime financiare shtesë.

55	Çmimet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
55501	Çmimet e importit			Y	Y	Y	Y
55601	Çmimet e shërbimeve			Y	Y	Y	Y
55701	Çmimet e ndërtimit		Y	Y	Y	Y	Y



**6. STATISTIKAT BUJQËSORE, TË PYJEVE DHE PESHKIMIT**

61	Përdorimi i Tokës	2006	2007	2008	2009	2010	2011
61101	Përdorimi i tokës	X	X	X	X	X	X
62							
62102	Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore			Z			
62103	Vrojtim mbi strukturën e njësive ekonomike bujqësore		Z		Z		Z
63							
63101	Llogaritë ekonomike të bujqësisë	y	y	y	y	y	y
64							
64101	Vrojtimi vjetor bujqësor (bimët e arave dhe pemëtaria)	X	X	X	X	X	X
65							
65101	Vrojtimi vjetor bujqësor (blegtoaria)	X	X	X	X	X	X
66							
66101	Informacion mbi Agro-industrinë						
68							
68801	Statistikat e pyjeve	Y	Y	Y	Y	Y	Y
69							
69101	Statistikat e peshkimit	X	X	X	X	X	X

**x-** indikatorët aktualë

**y-** nevojë për burime shtesë

**z-** mungesë burimesh

**6.1 Objektivat e programit për statistikat bujqësore**

- Rregjistrimi i përgjithshëm i bujqësisë përfshirë këtu blegtorinë dhe pyjet.
- Vrojtime periodike për strukturën e fermës (çdo 2 vjet)
- Përmirësimi i treguesve statistikor në përputhje me kërkesat e EUROSTAT

**6.2. Indikatorët që prodhohen aktualisht nga sektori i bujqësisë**

- Struktura e njësive ekonomike bujqësore
- Imputet e punës në bujqësi
- Llogaritë ekonomike për bujqësinë
- Prodhimet blegtorale dhe bujqësore
- Bilancet e produkteve bujqësore dhe blegtorale
- Statistikat e peshkimit
- Statistikat e pyjeve.

### 6.3 Rezultatet e pritshme

- Krijimi i regjistrit kombëtar të njësive ekonomike bujqësore dhe përdorimi i tij si mjet për ndërmarrjen e vrojtimeve statistikore në fushën e bujqësisë.
- Ndërtimi i treguesve statistikorë të harmonizuar me standartet ndërkombëtare të Eurostat-it dhe në shërbim të plotësimit të kërkesave të llogarive kombëtare.

### 6.4 Burimet

Aktualisht sektori ka burime të mjaftueshme për të prodhuar statistikat për:

- Përdorimin e tokës
- Statistikat e prodhimit bimor (bimët e arave dhe pemëtaria )
- Statistikat e prodhimit blegtoral.
- Statistikat e peshkimit

## 7. FUSHA TË TJERA STATISTIKORE

71	Statistikat e ambientit	2006	2007	2008	2009	2010	2011
71101	Ndotja e Ajrit dhe Ndryshimet Klimaterike	x	x	y	y	y	y
71102	Statistikat për Burimet Ujore						
71103	Statistikat për Mbetjet						
71104	Transporti dhe Mjedisi						
71105	Investimet për Mbrojtjen e Mjedisit dhe taksat Mjedisore						
71106	Bujqësia dhe Mjedisi						
71107	Biodiversiteti	x	x	x	y	y	y
71108	Statistika Rajonale Mjedisore						
71109	Statistikat e përdorimit të tokës						
71110	Statistika për disa indikatorë të ujit						

## Objektivat kryesorë për Statistikat Mjedisore për periudhën 2007-2011

- Të organizojë një model grumbullimi të dhënash Mjedisore unik për të gjitha Agjensitë statistikore që prodhojnë informacion Mjedisor, mbështetur në kërkesat e sistemit statistikor europian.
- Të harmonizojë statistikat e mjedisit me kërkesat e direktivave për raportimet dhe direktivave të tjera të sektorëve të ndryshëm të mjedisit në Acquis Communautaire.
- Të vendosë bashkëpunim dhe të koordinojë aktivitetet me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave për realizimin e detyrimeve të saj raportuese në KE, në Agjencinë Europiane të Mjedisit apo konventa të ndryshme.
- Të monitorojë progresin dhe efektivitetin e politikës mjedisore përmes indikatorëve sektoriale energji-mjedis dhe transport-mjedis; shëndet-mjedis, bujqësi-mjedis sipas modeleve europaine

## Roli i INSTAT-it në lidhje me Statistikat e Mjedisit

Të dhënat Mjedisore prodhohen nga Agjensitë Statistikore dhe nga Institucionet kërkimore shkencore që kryejnë monitorime mjedisore.

MMPAU publikon vetëm Raportin e "Gjëndjes së Mjedisit" 1 herë në dy vjet jo sipas sistemit DPSRI

INSTAT ka përgjegjësinë dhe autoritetin në mbledhjen e Informacionit të nevojshëm Mjedisor, analizimin, përpunimin dhe publikimin e këtyre të dhënave si **Statistika Zyrtare Mjedisore** sipas kërkesave të Konventës së Aarhus të ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar.

Siç paraqitet më poshtë kemi mungesë të dhënash për shumë nga Indikatorët Mjedisorë, për të cilat INSTAT ka detyrime raportuese në EUROSTAT

- 1- **Statistikat e Ajrit-Pjesërisht;** Jo të gjithë indikatorët e **AJRIT** janë matur. Nuk ka statistika zyrtare dhe as raportim. Akoma nuk ka një metodologji të zhvilluar kombëtare për këto indikatorë. Ka disa të dhëna për cilësinë e Ajrit: PM10, SO2, NO2, Pb3, O3. Të dhënat nuk janë mjaftueshëm të besueshme, Pajisjet e monitorimit të vjetëruara, periodiciteti i matjeve dhe mungesë e kontrollit të cilësisë së të dhënave
- 2- **Statistikat e ujit- Pjesërisht;** Jo të gjithë indikatorët e **UJIT** janë matur. Mungojnë të dhëna zyrtare për përdorimin e burimeve të ujit të freskët nuk ka Raportim(indikator i pamatshëm) Kemi disa të dhëna për cilësinë e ujrave sipërfaqësor (Për lumenjtë dhe liqenet; Nitritet, Nitratet, NH3. P total, Përmbajtja e Karbonit organik-(IHM). Për ujrata nëntokësore: NO4, NO3, NO2 (SHGJSH). Ka disa të dhëna të pjesshme për sasinë e klorofilës në ujrata detare ndërkuftar.
- 3- **Statistikat e mbetjeve- Mungojnë;** Indikatorët nuk janë matur, nuk ka statistika zyrtare dhe as raportim. Ka disa të dhëna vetëm për mbetjet e ngurta urbane por nuk janë mjaftueshëm të besueshme, kanë dalë me përlogaritje. Klasifikimi i plehrave akoma nuk është bërë realitet. Indikator i pamatshëm edhe për trajtimin e ujrave të mbetura urbane si pasojë nuk ka statistika zyrtare dhe as raportim. Indikator i pamatshëm edhe për mbetjet e rrezikshme të ngurta dhe të lëngëta, si pasojë nuk ka statistika zyrtare dhe as raportim

- 4- Statistikat e Transportit dhe Mjedisit; Pjesërisht.** Jo të gjithë indikatorët e ndikimit të transportit në mjedis janë matur. Sigurohen disa të dhëna për numrin e aksidenteve, pjesërisht për volumin e transportit dhe për bilancin e energjisë. Nuk maten indikatorët e përdorimit të karburantëve të pastra dhe alternative, si pasojë nuk ka statistika zyrtare dhe raportim. Nuk maten indikatorët e konsumit të energjisë së rinovueshme, konsumit të energjisë sipas sektoreve dhe vendosja e pajisjeve katalitike.
- 5- Statistikat për Investimet për Mbrojtjen e Mjedisit dhe taksat Mjedisore- Mungojnë;** Nuk ka statistika zyrtare dhe as raportim për investimet sipas NACE dhe investime sipas kërkesave mjedisore, investime për banorë në % të PBB, investime sipas sektorëve të industrisë. Ka disa të dhëna për taksën e plehrave, të gjelbërimit dhe të transportit por nuk ka **statistika zyrtare** dhe raportim.
- 6- Statistika për Bujqësinë dhe Mjedisin- Pjesërisht;** Jo të gjithë indikatorët janë matur. Nuk maten indikatorët e bilancit ushqyes të tokës bujqësore. Ka disa të dhëna të pjeshme e të limituara në nivel lokal jo kombëtar për disa monitorime të tokës bujqësore dhe të ujit për vaditje. Ka disa të dhëna për sasinë e shitjes së Pesticideve dhe plehrave kimike. **Nuk maten indikatorët e përdorimit të pesticideve sipas kulturave** si pasojë nuk ka statistika zyrtare dhe raportim. Nuk maten indikatorët e sipërfaqes së tokës bujqësore që përdor plehra organike, nuk ka **statistika zyrtare** dhe raportim.
- Nuk maten indikatorët për progresin e menaxhimit të zonave të ndotura (hot-Spot), si pasojë nuk ka **statistika zyrtare** dhe raportim.
- 7- Statistika për Biodiversitetin; Pjesërisht;** Jo të gjithë indikatorët janë matur. Ka disa të dhëna për diversitetin e habitatëve dhe ekosistemet e pyjeve. Ka të dhëna për prodhimin e akuakulturës, por nuk ka për statusin e peshkimit detar. Nuk maten indikatorët e eurozionit. Nuk ka të dhëna të sakta dhe zyrtare.
- 8- Statistika Rajonale Mjedisore; Mungojnë.** Nuk maten indikatorët Mjedisore Rajonale, si pasojë nuk ka statistika zyrtare dhe raportim.
- 9- Statistikat e përdorimit të tokës; Pjesërisht.** Ka indikatorë të matshëm për sipërfaqen e tokës të zënë nga pyjet dhe tokë e pyllëzuar, si pasojë ka statistika zyrtare dhe raportim.
- Nuk ka të dhëna për sipërfaqen e tokës së zënë me ndërtime për qëllime tregtare, publike dhe ndërtime industriale. Nuk ka statistika zyrtare për sipërfaqen e tokës të përdorur për transport dhe komunikim, të përdorur për infrastrukturë teknike. Ka disa të dhëna jo zyrtare për sipërfaqen e tokës së zënë me ujë.
- 10- Statistika për disa Indikatorë të ujit; Mungojnë;** Mungojnë indikatorët e matshëm dhe si pasojë nuk ka statistika zyrtare dhe Raportim

#### 4. KUSHTET E FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT STATISTIKOR KOMBËTAR

Në mënyrë që Sistemi Statistikor Kombëtar të funksionojë duhet të plotësohen disa kushte pa të cilat nuk është i mundur zbatimi i tij në kohë dhe në cilësi. Prandaj INSTAT po referon më poshtë listen e kushteve të domosdoshme dhe të mjaftueshme për të organizuar veprimtarinë e tij:

- Njohja e së drejtës për të përdorur burime të të dhënave primare individuale nga burime të tjera administrative.
- Hartimi, nënshkrimi dhe njohja e Marëveshjeve të Mirëkuptimit si pjesë integrale e Ligjit “Për Statistikën” me agjencitë e tjera statistikore për të lejuar njohje dhe përdorimin e burimeve të paeksploruara të të dhënave
- Roli i Këshillit të statistikës dhe grupeve të punës të jetë plotësisht i siguar për të vënë në jetë detyrat që rrjedhin nga Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare.
- Nënshkrimi i Marëveshjes së Stabilizim Asocimit, do të sjellë përpara INSTAT detyrime që lidhen si me fuqizimin e INSTAT vetë, edhe të shërbimit statistikor kombëtar.
- **Dhënia INSTAT e një buxheti të mjaftueshem** për të ndërmarrë të gjitha veprimtaritë statistikore të nevojshme për krijimin e produktit statistikor që duhet për të pasur indikator të vazhdueshëm
- **Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe hapësinore të INSTAT** për të realizuar detyrat e tij, është një kusht i domosdoshëm
- Edukimi dhe trainimi i vazhdueshëm i stafit në metodologji statistikore dhe më gjerë në aftësi profesionale, si dhe trainimi me njohuri të gjuhës angleze.
- Fuqizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve teknologjike jo vetëm për të mundësuar përpunimin e të dhënave dhe shpërndarjen e tyre, por edhe për të iniciuar projekte të reja në drejtim të grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.
- Përmirësimi në sistemin e pagesave të specialisteve dhe inicimi i një plani për zhvillimin e karrierës brenda institucionit.
- Hartimi i një programi për matjen e performancës manageriale të sistemit (SBI).
- Ngritje e sistemit të integruar të informacionit
- Inicimi i projekteve që lidhen me cilësinë e aktiviteteve
- Krijimi i një kulture statistikore në rritje, duke hartuar ditë të rëndësishme kombëtare të dedikura statistikës, apo organizimi i debateve të hapura për çështje profesionale të një rëndësie të veçantë.

## 5. ORGANIZIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE

Në bazë të nenit 9 të Ligjit “Për Statistikën” INSTAT financohet kryesisht nga buxheti i shtetit. Fondet që ai ngre nga ushtrimi i veprimtarisë së vet, si shitja e publikimeve apo shërbimeve mund t’i përdorë për rritjen e të ardhurave të tij, në përputhje me Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Rregullores të Ministrisë së Financave .

Gjithashtu ai mund të përdorë për të rritur të ardhurat e veta dhe fondet që vijnë nga mbështetjet financiare të donatorëve. Në çdo gusht INSTAT paraqet në Ministrinë e Financave nevojat e veta për financime, dhe në çdo dhjetor ai informohet për buxhetin e akorduar. Në përgjithësi midis kërkesës dhe akordimit ka diferencë të mëdha në mungesë të plotësisht të nevojave.

Edhe pse INSTAT paraqet skenarë zhvillimi të ndryshëm, që kanë nevojë për mbështetje të ndryshme financiare, asnjëherë nuk është plotësuar skenari minimal. Prandaj për mbarëvajtjen e Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare mbështetja me burimet financiare të nevojshme është një nga kushtet kryesore. Qëllimi i punës së INSTAT dhe padyshim dhe i stafit është sigurimi i vazhdimësisë së prodhimit statistikor. Në kushtet e kapaciteve njerëzore të kufizuar në numër dhe me një rrjedhje të konsiderueshme të stafit, sigurimi i vazhdimësisë së prodhimit është shumë i vështirë.

INSTAT ka nevojë të rritet padyshim në numër punonjësish, në ambiente të përshtatshme pune dhe të mbështetjet me një infrastrukturë teknike bashkëkohore.

## 6. PLANIFIKIMI I KOSTOS SË NEVOJSHME PËR OPERACIONET STATISTIKORE 2007-2011

Për të kryer operacionet e veta statistikore INSTAT ka nevojë për një mbështetje financiare të garantuar dhe në rritje gjatë gjithë periudhës kohore në të cilën mendohet të ndërmerren Aktivitetet statistikore sipas këtij plani që po propozohet.

Për hartimin e tabelës së kostove për periudhën Pesëvjeçare, INSTAT është mbështetur në strukturën e shpenzimeve buxhetore për vitin 2005-2006, të cilat kanë bërë të mundur realizimin e disa aktiviteteve që janë kryer pranë ndermarrjeve si dhe parashikimin në projekt-buxhet të Anketës së Forcave të Punës (pranë familjeve) për vitin 2007 mbështetur në VKM 430 Datë 28.06.2006.

Gjatë periudhës 2006-2007 është në proces Anketa e Buxhetit të Familjes e cila financohet plotësisht nga donatorët.

Nga qershori 2006 e në vazhdim INSTAT ka 151 punonjës të Strukturës Organike të ndarë midis Drejtorisë Qëndrore dhe Drejtorive Rajonale në rrethe në raport 1/1.

Drejtoritë Rajonale në rrethe janë përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave të anketave dhe për publikimin e një buletini statistikor me të dhëna nga i gjithë aktiviteti ekonomik, social dhe bujqësor i zhvilluar në rreth.

INSTAT operon në hapësira të kufizuara pune dhe me pak mjete lëvizëse për të ndjekur operacionet në rrethe.

Shumë shpesh është menduar për një organizim tjetër të teknologjise së prodhimit të informacionit statistikor, por ende çdo mase që do të merret është e pavlefshme të kryhet, për sa kohë nuk ka një garantim që grumbullimi i të dhënave nuk do të varet vetëm nga njërezit (të egzistojnë mjete logjistike që të mundësojnë grumbullimim via e-mail ose forma të tjera dixhitale) si dhe sa kohë që ende ka diskutime për ndarjen administrative të vendit. Prandaj në këto kushte është i parakohshëm një organizim ndryshe i punës së INSTAT dhe nevoja për burime financiare që shtojnë të dhënat parësore është vazhdimisht në rritje.

Në Tabelën 6.1 jepet një shpërndarje e numrit të Aktiviteteve statistikore sipas tipit dhe vitit kur është planifikuar të zhvillohen.

Tabela 6.1 Numri i Aktiviteteve Statistikore sipas tipit dhe viteve të kryerjes

Aktiviteti Statistikor	2007	2008	2009	2010	2011
Vrojtime në ndermarrjeve	14	15	16	16	16
Vrojtime në familje	2	1	1		
Regjistrime te pergjithshme <sup>1</sup>		1	1		1
Të dhëna administrative	98	99	96	95	97
Gjithsej	114	111	114	111	114

<sup>1</sup> Në këtë grup përfshihen regjistrimet për ndërmarrjet, për ekonominë bujqësore dhe i popullsisë. Kostoja e tyre nuk është përfshirë në koston e përgjithshme të aktiviteteve statistikore.

Në tabelën 6.2 paraqitet struktura e kostos për Aktivitetet statistikore të realizuara me fonde buxhetore për vitet 2005, 2006 nga INSTAT.

Tabela 6.2 Struktura e kostos

Zëri i kostos	Në mijë Lekë	
	2005	2006
Kosto për vrojtime (grumbullim të dhënash)	27,079	19,982
Kosto për mbeshtetje aktiviteti (trejnime, software, shtypje pyetësorësh)	18,822	14,309
Shpenzimeve personeli	73,353	89,214
Kosto Fikse	12,741	12,191
Gjithsej	131,995	135,696

Në tabelën 6.3 jepen përlogaritjet që INSTAT ka kryer për nevojën e financimeve që ai ka për të kryer aktivitetet statistikore sipas programit Pesëvjeçar të statistikave zyrtare.

Tabela 6.3 Përlogaritjet për shpenzime për kryerjen e Aktiviteteve statistikore

Shpenzime	Në mijë Lekë				
	2007	2008	2009	2010	2011
Vrojtime në ndermarrje	58,871	61,815	64,905	68,151	71,558
Vrojtime në familje	12,651	12,651	12,651		
Regjistrime					
Shpenzime Institucionale	102,455	108,602	118,027	125,109	132,615
Gjithsej	173,977	183,068	195,583	193,259	204,173

Shpenzimet në vitin 2010 do të rriten si rezultat i kryerjes së Regjistrimit të Njësive Ekonomike Bujqësore. Ndërsa që nga viti 2007 e në vazhdim do të fillojnë të kryhen Vrojtimet pranë familjeve Anketa e Forcave të punës (LFS).



## 7. MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT

Me qëllim sigurimin e funksionimit efektiv të qeverisjes në përgjithësi, nevojiten të dhëna statistikore të një cilësie të lartë. Vendimarrësit politikë dhe aktorët e tregut në mënyrë të vazhdueshme mbështeten në statistika për marrjen e vendimeve si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të këtyre vendimeve. Prioritetet e qeverisë për të përshpjeguar procesin e përafrimit me BE, sjell në mënyrë të pashmangshme rritjen e vëllimit të të dhënave statistikore të kërkuara, sikurse edhe nevojën për krahasueshmerinë dhe përmirësimin e cilësisë së tyre.

Në se statistikat janë për të kënaqur nevojat e përdoruesve, ato duhet të jenë të besueshme, të pavarura nga ndërhyrjet politike dhe të disponueshme në kohën dhe në formën më të përshtatshme për përdoruesit. Përgaritja e statistikave nuk duhet të përbëjë një barrë shtesë për ofruesit e të dhënave.

Programi Statistikor Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare duhet të bejë të mundur një përshkrim të strategjive, prioriteteve dhe programeve të punës të planifikuara për kohëzgjatjen e këtij programi. Ky program botohet në Fletore Zyrtare..

Monitorimi i implementimit të Programit Statistikor specifikohet në Nenin 8 dhe 11 të Ligjit “Për statistikave kombëtare” të Republikës së Shqipërisë së bashku me ekzekutuesit e autorizuar të statistikave kombëtare të përcaktuar në Programin Statistikor dhe duhet që gjatë pesë viteve të programit të mësipërm t’i prezantojnë Këshillin Statistikor një Raport Vjetor për punën e kryer si dhe të prezantojë një kopje në zyrën e Zëvendëskryeministrit. Ndryshimet në programin vjetor mbas diskutimeve me Këshillin e Statistikave duhet të botohen në Fletoren Zyrtare.

Zbatimi i programit do të monitorohet në mënyrë periodike nga Këshilli Statistikor dhe përdoruesit dhe prodhuesit e të dhënave të cilët janë të nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve të statistikave kombëtare si edhe për perputhjen me kërkesat ndërkombëtare. INSTAT për këtë qëllim, në periudhë më të shkurtrë se një vit paraqet raporte të shpejta monitorimi në Këshillin e Statistikës.

Grupet teknike të punës krijohen brenda INSTAT në bashkëpunim me Agjencitë e tjera Statistikore, në kuadrin e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit që mbulojnë fusha të ndryshme statistikore dhe diskutojnë Programet e propozuara Vjetore dhe Vrojtimit Statistikore. Këtyre strukturave i takon gjithashtu edhe diskutimi i Programit Statistikor Vjetor dhe ndërgjegjësimi i agjencive përkatëse. Së bashku me prodhuesit e statistikave kombëtare ata sigurojnë harmonizimin maksimal të prioriteteve të dhëna në programin pesë-vjeçar me ato të programeve vjetore gjatë gjithë jetës së vetë programit. Për më tej, ata sigurojnë gjithashtu që statistikat të reagojnë vazhdimisht kundrejt të gjitha ndryshimeve të mjedisit ekonomik, social dhe mjedisor në vend.

INSTAT dhe ekzekutuesit e autorizuar përgatisin një raport mbi punën e kryer sipas programit vjetor të mëparshëm deri më 30 Prill të vitit aktual për vitin e mëparshëm. Raporti diskutohet nga Këshilli Statistikor si dhe rishikohet dhe analizohet.

Në diskutimet e marrëveshjes së stabilizim asocimit për hyrjen në BE, INSTAT mori persiper të koordinojë përafrimin sa më shumë të mundshëm të statistikave kombëtare të Shqipërisë me acquis në fund të 2014. Detyrimet e INSTAT janë: të krijojë një kulturë në rritje statistikore midis agjencive të tjera dhe të ndjekë shkallën e përpjekjeve për të realizuar detyrimet e MSA nga këto agjensi.

## **Pjesa e II-të**

**Propozime për tregues statistikorë të rinj ose përmirësime të treguesve egzistues, me burime njerëzore dhe financiare shtesë**

## Hyrje

Misioni i INSTAT-it është të sigurojë të dhëna transparente, neutrale dhe në kohë të cilat mund të ndihmojnë gjykimin e përdoruesve në zhvillimin e proceseve transformuese brenda vendit. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit sjell për INSTAT-in detyrime të mëtejshme të lidhura këto me forcimin e INSTAT-it dhe me sistemin e statistikave kombëtare, një buxhet i përshtatshëm për INSTAT-in, në mënyrë që të ndërmerren të gjitha aktivitetet statistikore të nevojshme për krijimin e një produkti statistikor, i nevojshëm për vazhdimësinë e treguesve. Një kusht tjetër për përmbushjen e këtyre detyrave është dhe rritja e burimeve njerëzore dhe ambienteve shtesë për INSTAT-in.

Nga krahasimi i bërë me vendet e tjera tregohet qartë se burimet e shpenzuara në Shqipëri për statistikat zyrtare janë relativisht të vogla. Gjithsej janë 15 persona të stafit të INSTAT-it dhe disa punonjës të institucioneve të tjera të cilët prodhojnë statistika zyrtare. Numri i përgjithshëm i punonjësve në Shqipëri është rreth 200, përfshirë këtu edhe personelin e punësuar me kontratë.

Shqipëria ka rreth 3.1 milion banorë. Kjo do të thotë se janë rreth 0.05 deri 0.06 punonjës statistike për 1000 banorë. Kjo mund të krahasohet me 0.12 punonjës në Maqedoni dhe 0.08 në Kroaci. Latvia ka një popullsi prej 2.3 milion banorësh me një numër punonjësish prej 0.19. Në Europën Perëndimore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada shifrat janë tek rreth 0.20 punonjës për 1000 banorë. Prodhimi statistikor në Shqipëri është më tepër punë- intensive (prania e teknologjisë moderne në procesin e prodhimit statistikor kryesisht në formatin e grumbullimit të informacionit të të dhënave primare, është e mangët dhe përgjithsisht manuale) sesa në këto vende, që do të thotë se diferencat në të vërtetë janë akoma dhe më të mëdha.

INSTAT-i po ndërmerr veprime për të qënë më eficient. Janë instaluar paisje informatike me mbështetjen e donatorëve. Gjithashtu rekomandohet për INSTAT-in të riorganizojë strukturat e tij në rrethe dhe mbledhjen e të dhënave. Megjithatë kjo kërkon kohë për aq kohë sa INSTAT varet nga zhvillimi i infrastrukturës në vend në tërësi. Një qëllim tjetër është gjithashtu dhe maksimizimi i përdorimit të burimeve administrative.

Pavarësisht nga këto përpjekje për Shqipërinë do të jetë e vështirë të përmbushi kërkesat e EUROSTAT-it pa patur një rritje substanciale të buxhetit dhe stafit për statistikat zyrtare.

Do të duhet gjithashtu kohë për të ngritur dhe përmirësuar institucionin. Do të jetë e nevojshme një përjasje hap pas hapi dhe dhënia përparësi e disa fushave të caktuara të statistikave. Nevoja e përmirësimit të Llogarive Kombëtare dhe të dhënave të tjera makroekonomike është shprehur dhe nga përdoruesit kryesorë të statistikave.

Në materialin në vazhdim, janë listuar disa prej aktiviteteve statistikore, të cilat INSTAT ka kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme profesionale për t'i përballuar, por realizimin i tyre varet nga sigurimi i fondeve buxhetore shtesë e në mënyrë periodike.

Propozimi për një rritje të burimeve paraqitet në këtë pjesë të dytë të buxhetit afat-gjatë.

## DETYRAT KRYESORE STATISTIKORE DERI NË FUND TË VITIT 2011

Qeveria Shqiptare synon drejt integritit europian dhe drejt zbutjes së varfërisë nëpërmjet strategjive shumë të qarta të zhvillimit legjislativ dhe social ekonomik të vendit. Strategjitë e hartura synojnë një rritje ekonomike, zbutje të informalitetit, hapje më të gjerë ekonomike, thithje të investimeve të huaja si dhe synojnë drejt një zhvillimi të qëndrueshem rajonal. Të gjitha këto si dhe pikënisja nga dokumentat e Programit Statistikor të Komunitetit Europian, përbëjnë bazën themelore ku mbështeten detyrat kryesore të INSTAT.

**Maksimizimi i përdorimit të burimeve administrative.** Agjencitë e tjera statistikore, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre grumbullojnë të dhëna që mund të përdoren (ose jo) për qëllime statistikore. INSTAT mbas krijimit të një regjistri me karakteristika unike për të gjitha Insitucionet Qëndrore dhe Ministrinë duhet të organizojë një model grumbullimi të dhënash unik për to, me përgjegjësi hierarkike të përcaktuara. Kjo gjithashtu do të shërbejë për një ndërgjegjësim më të mirë të furnizuesve administrativë mbi statistikën zyrtare dhe rolin që ato luajnë në monitorimin e reformave dhe politikave qeveritare.

**Përmirësimi i mënyrës së llogaritjes së treguesve të agreguar makroekonomike si dhe sistemit të llogarive kombëtare,** duke u përafëruar me ESA 95. Një vlerësim i situatës së burimeve primare egzistuese dhe të mungura do të ndihmojë në hartimin e një listë operacionesh që do të sjellë përmirësimin e llogaritjes së Llogarive Kombëtare. Të dhënat e përmirësuara do të ndihmojnë në llogaritjen e PBB provizore në periudha kohore më të ngushta jo vetëm sipas prodhimit, por edhe sipas shpenzimeve me çmime korrente dhe konstante.

**Përmirësimi i matjes së Ekonomisë së Pa Vrojtuar (EPV).** Shqipëria duhet të adaptojë edhe më shumë rekomandimet e OECD/ ES/ ECEUN në matjen ekonomisë së pa vrojtuar. Do të konsolidohet metoda e re në llogaritjen dhe vlerësimin e ekonomisë së pavrojtuar, sipas metodikës “labour input” por edhe duke rritur shkallën e përdorimit të të dhënave që vijnë nga burimet administrative si, inspektoriat i punës, tatim –taksat etj.

**Të dhëna të shpejta makroekonomike (GDP flash estimation).** Për t'i ardhur në ndihmë të gjithë vendimarrësve, duke përdorur vlerësime mbi bazën e disa metodave ekonometrike, të dhënat e GDP vjetore të kombinuar me të dhënat nga indeksi i shitjeve dhe të përmirësuar me deflatorë të ndryshëm sipas degëve, do të mundësojnë llogaritjen dhe publikimin e PBB tremujore.

**Të dhëna strukturore mbi ndërmarrjet.** Do të shërbejnë për të përmirësuar situatën e repertorit të ndërmarrjeve, duke përfshirë çdo të dhënë që i shërben përmirësimit të cilësisë së regjistrimit. Gjithashtu futja e elementeve të rinj në grumbullimin e të dhënave si forma elektronike dhe përdorimi i burimeve administrative të përmirësuar, me siguri do të sjellë një përmirësim të ndjeshëm në statistikën e ndërmarrjeve.

**Të dhënat e tregtisë së jashtme dhe Intrastat.** Kalimi i të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me informacionin mbi identifikimin e ndërmarrjeve individuale që kryejnë transaksione tregtare, do të ndihmojë që të kuptohet më mirë ecuria e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve. INSTAT do të vazhdojë të dërgojë informacion mbi tregtinë e jashtme në ES, dhe së bashku në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave do të përpiqet të përmirësojë cilësinë e të dhënave të dërguara.

**Statistikat sociale**, të dhënat mbi individët dhe familjet. Objekti i programit të këtyre statistikave është të sigurojë informacion mbi individët dhe familjet, duke kombinuar burimet e të dhënave. Nga njëra anë përdorimi i të dhënave administrative të jep një informacion numerik, por ndërthurja e tyre të lejon të përlogariten indikatorë që dëshmojnë për nivelin e një treguesi të ri që pasqyron më mirë gjëndjen e individëve dhe në raste të rralla edhe të familjeve, lidhur me situatën e tyre demografike, të punësimit, kulturore dhe arsimore. Për një vështrim më të plotë të gjendjes lipset që këto të dhëna të ballafaqohen me treguesit që dalin nga vrotimet statistikore. Aktualisht për këto statistika ka vetëm një vrotim pranë familjeve, i cili është i garantuar me fonde vetëm për vitin 2007. Qendrueshmëria në të dhënat statistikore mbi të ardhurat e shpenzimet e familjeve, varet shumë nga përfshirja në programin statistikor 5 vjeçar të një vrotimi vjetor, dobishmëria e të cilit ndikon jo vetëm në përmirësimin e statistikave të familjeve por edhe në përmirësimet vlerore të treguesve makro, si IÇK dhe PBB.

**Statistikat bujqësore.** Gjatë kësaj periudhe një transformim i vërtetë duhet bërë në statistikave bujqësore në mënyrë që ato të përafrohen me kërkesat komunitare duke dhënë një pamje më të plotë të realitetit bujqësor të vendit. Por nga ana tjetër ato duhet të përmirësohen që të ndihmojnë në më mirë llogaritjen e PBB.

Sektorë të tillë si peshkimi apo pylltaria duhet të zënë vend në statistikave zyrtare në formë më të plotë, sidomos për të ndjekur zhvillimet që lidhen edhe me Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, MTL.

**Statistikat mjedisore.** Këto po bëhen gjithnjë e më shumë të rëndësishme për vendin, prandaj bashkëpunime shumë preçise janë të domosdoshme të hartohen dhe të ndiqen me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Hartimi i një listë indikatorësh për ndjekjen e Marrëveshjes së Kiotos është i domosdoshëm në këtë fazë.

**Statistikat rajonale.** Do të shërbejnë për të ndihmuar në përcaktimin e NUTS (Nomeklatura e Njësive Teritoriale Statistikore) që duhet të zgjedhim për të monitoruar kohëzisionin social dhe ekonomik midis rajoneve, demografinë e bizneseve, situatën e njësive të vogla bujqësore, mënyrën si implementohen reformat dhe përcaktimin e fondeve mbi to.

#### **Propozimet e reja lidhen me përmirësimet të mëtejshme në këto fusha kryesore:**

- A. STATISTIKAT MAKRO-EKONOMIKE
- B. REGJISTRIME TË PËRGJITHSHME
- C. PËRMIRËSIME TË STATISTIKAVE PRIMARE

#### **A. Përmirësimi i statistikave makro-ekonomike**

Objektivi kryesor dhe afatgjatë i statistikave makro është: përafrim më i shpejtë me kërkesat e ESA'95. Përmirësimet sipas prioriteteve të shprehura edhe në planin e zhvillimit të llogarive kombëtare janë

1. Vlerësimet e përmirësuara të ekonomisë së pa vrotuar
2. Përmirësimet metodike të PBB sipas metodës së shpenzimeve
3. Prodhimi i tabelave ofrim - përdorimi
4. Përmirësim të Vlerësimit të PBB-së me çmime konstante, (viti bazë)
5. Llogaritja dhe publikimi i PBB tremujore

Realizimi në praktikë i këtyre objektivave lidhet ngushtësisht me përmirësimin e vazhdueshëm të burimeve egzistuese dhe të reja të informacionit .

Kështu kur të dhënat nga Anketa e Forcave të Punës do të jenë të gatshme atëherë do të krijohet mundësia e të bërit të vlerësimeve të para në bazë të së ashtuquajturës Metoda e Labour Input.

Deri më tani nuk janë zhvilluar vlerësime të plota të PBB-së sipas metodës së shpenzimeve. Anketa e re e Buxhetit të Familjeve dhe një informacion më i mirë mbi shpenzimet e qeverisë do të përmirësonin mundësitë e nxjerrjes së këtyre rezultateve.

Për Llogaritë Kombëtare nuk ka ende tabela ofrim-përdorimi. Këto janë të nevojshme për kontrollimin e konsistencës në materialet e të dhënave dhe gjithashtu në periudhën afat-gjatë për ndërtimin e tabelave input-output.

Ka një nevojë emergjente për prodhimin e llogarive tremujore. Përdoruesit kryesorë si Ministria e Financave dhe Banka Qëndrore e Shqipërisë kërkojnë që këto përlogaritje t'u ofrohen në një kohë sa më të shpejtë. Statistikat e reja afat-shkurtra do të përmirësojnë mundësitë e prodhimit të llogarive të këtij treguesi.

**Tab.1.** Përmirësimi i Llogarive Kombëtare 2007 - 2011

<b>Llogaritë ekonomike vjetore</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>
Vlerësimet e ekonomisë së pa vrojtuar	x		y	Y	y	y
PBB sipas metodës së shpenzimeve				Y	y	y
Prodhimi i tabelave ofrim - përdorimi				Y	y	y
Vlerësimi i PBB-së me çmime konstante, (viti bazë)					y	y
<b>Llogaritë ekonomike tremujore</b>						
Llogaritë tremujore			y	Y	y	y

X- produkte/tregues ekzistues

0- jo-ekzistues

Y- burime shtesë

### Objektivat për zhvillimin e Llogarive Kombëtare

1. Vlerësime më të mira të ekonomisë së pa vrojtuar duke filluar nga 2008-a
2. Zhvillimi i vlerësimeve të pavarura të PBB-së nga përqsja e shpenzimeve nga 2009-a
3. Prodhimi i tabelave ofrim-përdorimi nga 2009-a bazuar në burimet e reja statistikore
4. Matja e PBB-së me çmime konstante në një vit bazë të dhënë
5. Zhvillimi i zbatimit të llogarive tremujore nga 2008-a
6. Arritja e kërkesave të Standarteve Speciale të Shpërndarjes të të Dhënave SDDS nga FMN-ja në 2008

**Aktivitetet statistikore që duhen ndërmarrë për realizimin e objektivave**

1. Vlerësimi i ekonomisë së pa vrojtuar bazuar në Metodën e Labour input me të dhënat nga anketa e forcave të punës, 2007-2009
2. Vlerësimi i PBB-së sipas metodës së shpenzimeve
  - Anketa e re e Buxhetit të Familjeve do të përdoret për vlerësimet e konsumit privat, aktualisht ka fonde vetëm për vitin 2007
  - Sistemi i ri i thesarit do të japë informacionin e duhur për të gjitha transaksionet me autoritetet qendrore, rajonale dhe lokale. Do të ketë përmirësime thelbësore të regjistrimit të transaksioneve për sektorët e Shëndetësisë dhe Arsimit. Metodologjia e FMN-së për Statistikat e Financës së Qeverisë, GFS dhe Klasifikimi i Funksioneve të Qeverisë COFOG. Informacioni i mbledhur nga sistemi do të përdoret për vlerësimet e PBB-së
  - Informacioni mbi formimin e kapitalit fiks bruto do të mblidhet në një anketë të veçantë
  - Informacioni mbi eksportin dhe importin do të merret nga statistikat e tregtisë
3. Prodhimi i tabelave të ofrim – përdorimit
  - Duhet të vlerësohet oferta e të mirave dhe shërbimeve sipas produktit dhe llojit të ofruesit dhe kjo realizohet nëpërmjet një ankete specifike për produktet e cila deri tani nuk është realizuar.
  - Do të veçohen importet dhe outputi nga industria vendase
  - Tabela e përdorur do të ndërtohet duke treguar përdorimin e të mirave dhe shërbimeve për produkt dhe lloj përdorimi si konsum i ndërmjetëm (në procesin e prodhimit nga industria), konsumi final, formimi i kapitalit bruto ose eksporteve
4. Vlerësimi i PBB-së me çmime konstante në një vit bazë të dhënë
  - PBB-ja përbëhet nga çmimet korrente dhe ato të vitit të kaluar. PBB-ja me çmimet korrente do të mblidhet për një periudhë më të gjatë. Statistikat e çmimeve duhet të përmirësohen për këtë qëllim
5. Zhvillimi i zbatimit të llogarive tremujore nga 2008-a e mëtej
  - Do të përmbushet testi i përqasjes së llogarive tremujore. Do të përmirësohen metodat e përlllogaritjes së llogarive tremujore. Do të testohen gjithashtu burime të reja të vlerësimit

## Indikatorët e përmirësuar

Për përmirësimin e Llogarive Kombëtare në Shqipëri të sugjeruara këtu është ndonjëherë e nevojshme caktimi i plotë i anketave të reja në subjektet që i përkasin statistikave. Në raste të tjera është e mjaftueshme përmirësimi mbulimit ose përmbajtjes së anketës ekzistuese.

1. Vlerësimet e përmirësuara të ekonomisë së pa vrojtuar duke filluar nga 2008

### **Anketa të reja ose të përmirësuara:**

**Anketa e Forcës së Punës** i jep një input të rëndësishëm vlerësimeve të ekonomisë së pa vrojtuar. Aktualisht nuk nevojitet asnjë anketë e re. Është megjithatë e rëndësishme që kjo anketë të vazhdojë edhe pas këtij 3-vjeçari për të cilën është gjetur financimi.

### **Mungesë fondesh për anketën e forcave të punës për periudhën 2010-2011**

2. Zhvillimi i vlerësimeve independente të PBB-së sipas metodës së shpenzimeve nga 2009

### **Anketa të reja ose të përmirësuara:**

Do të përdoret Anketa e re e Buxhetit të Familjes. Ashtu si edhe për Anketën e Forcës së Punës është e rëndësishme vazhdimësia e saj edhe pas 2009. Është gjithashtu e rëndësishme mundësia e vlerësimit të Shpenzimeve të Përgjithshme të Qeverisë nga mbledhja e të dhënave që po prezantohet nga Ministria e Financave.

### **Mungojnë fondet për anketën e buxhetit të familjeve për periudhën 2008-2011.**

Nevojiten disa anketa të reja:

- Anketë për shpenzimet për Organizatat jo –Qeveritare, çdo 3 vjet
- Anketë për investime në kapitalin bruto
- Anketë e ndërmarrjeve në aktivitetet e shërbimeve (kompanitë e sigurimit dhe të tjera)
- Anketa strukturore në bujqësi dhe aktivitetet forestiale

3. Prodhimi i tabelave ofrim-përdorim nga 2009 bazuar në burime të reja statistikore  
Rregjistri i statistikave të biznesit duhet të përmirësohet. Duhet gjithashtu të përfshijë njësi lokale për ndërmarrjet komplekse.

### **Anketa të reja ose të përmirësuara:**

- Anketë ndërmarrje mbi prokukte në nivel prodhimi
- Përmirësime të informacionit në përdorim të lëndës së parë në Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve
- Anketë për tregtinë në diferencat e lejueshme
- Anketë për transportin në diferencat e lejueshme



4. Vlerësimet e PBB-së me çmime konstante në një vit bazë të dhënë

**Anketa të reja ose të përmirësuara:**

- Përmirësim të statistikave të çmimeve nga zgjerimi i fushës së mbulimit (nr.ndërmarrjesh, aktivitete ekonomike), etj veçanërisht në sektorin e ndërtimeve.

5. Zhvillimi i zbatimit Llogarive tremujore nga 2008 e mëtej

**Anketa të reja ose të përmirësuara:**

- Përmirësimi i statistikave afat-shkurtra të biznesit dhe prezantimi i vlerësimeve të shpejta

## B. Regjistrime të përgjithshme

### B.1 Rregjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike jo bujqësore

Situata aktuale (problemet kryesore), justifikimi i nevojave për projekte bazuar në sfidat për çdo sektor:

Që nga 1994 INSTAT-i ka ngritur regjistrin administrativ të ndërmarrjeve jo-bujqësore. Ngritja e këtij regjistri u realizua bazuar në të dhënat administrative të marra nga zyrat rajonale të tatimeve. Rëndësia e këtij regjistri administrativ është e lidhur me funksionet e tij siç janë baza për kuadrin e Mostrës për të realizuar vrojtimit statistikore, analizat demografike të ndërmarrjeve, publikimi i të dhënave të ndërmarrjeve dhe së fundi si një mjet marketingu që i ofron përdoruesve listat e ndërmarrjeve sipas kërkesave të tyre për analizat e tregut.

Regjistri aktual i biznesit megjithë rolin e rëndësishëm që ka luajtur deri më tani, ka disa probleme lidhur me cilësinë e dobët të variablave të ndryshëm, përsëritje në regjistër, ndërmarrje të pa regjistruara, prani të ndërmarrjeve jo aktive, mungesë informacioni të punonjësve, etj. Këto probleme kryesisht vijnë si pasojë e cilësisë së dobët të burimeve administrative të informacionit. Një regjistrim ekonomik do të zgjidhte problemin më kryesor të lartpërmendur të regjistrit, që është gjithëpërfshirja dhe do të sigurote prezencë më të mirë të të gjithë operatorëve ekonomikë në ekonominë shqiptare dhe do të sillte përfundimisht një cilësi më të mirë të statistikave të ndërmarrjeve.

Eksperiencia profesionale e arritur deri më tani nëpërmjet 2 regjistrimeve të tjera tashmë të kryera nga INSTAT-i, popullsia dhe regjistrimi i ndërtesave në 2001 si dhe regjistrimi në sektorin e bujqësisë në 1998, sjell në qendër të vëmendjes rëndësinë e realizimit të regjistrimit ekonomik të ndërmarrjeve.

### Objektiva të përgjithshme / qëllimi i projektit

Nga pikëpamja statistikore një regjistrim ekonomik do të sillte një regjistër biznesi më të përditësuar sipas rekomandimeve ndërkombëtare, (EUROSTAT) dhe standarte që do të shërbenin për të prodhuar shkallë të ndryshme të statistikave ekonomike, të besueshme, të sakta dhe sa më në kohë pranë përdoruesve. Objektiva të mëtejshme për t'u arritur janë:

- Të sigurohet mbulimi i plotë i të gjithë njësive ekonomike që veprojnë në vend
- Përmirësimi i cilësisë së variablave të ndryshëm të ndërmarrjeve
- Të sigurohet regjistrimi i të gjitha njësive më të vogla

- Të shmangët duplikimi i ndërmarrjeve në regjistër
- Pastrimi i regjistrit të biznesit nga ndërmarrjet jo aktive

### Rezultatet e pritshme

- Të vendoset një cilësi e mirë e regjistrit të statistikave të biznesit
- Rritja e numrit të ndërmarrjeve të vogla në regjistër ashtu si edhe numri i variablave të ndryshëm bashkëngjitur me to
- Të sigurohet një shkallë më e gjërë e statistikave ekonomike me cilësi më të mirë dhe sipas standarteve europiane
- T'u jepen përdoruesve statistika ekonomike më të besueshme dhe të sakta

### Institucionet përfituese / ose institucione të përfshira në zbatimin e projektit

INSTAT, Administrata e Tatimeve, zyrat e punës, Dhoma e Tregtisë

Aktivitetet kryesore dhe llojet e asistencës / inputet e kërkuara

- Hartimi dhe aprovimi i ligjit specifik për zhvillimin e regjistrimit të njësive ekonomike jobujqësore, i përfshirë tashmë në ligjin e ri për statistikat
- Ngritja e sistemit të kartografisë i cili do të shërbejë për identifikimin më të mirë të njësive ekonomike jobujqësore
- Përdorimi i informacionit nga burimet ekzistuese për identifikimin më të mirë të njësive në zonat rurale
- Sigurimi i burimeve financiare për hartimin dhe zbatimin e regjistrimit të njësive ekonomike jobujqësore
- Ngritja e njësive të projektit për të siguruar zbatimin e projektit të regjistrimit të njësive ekonomike jobujqësore

#### Kostot e përfaqëta

<sup>1</sup> Kosto totale 1 milion euro, kontribut i donatorëve

### **B.2 Zhvillimi i regjistrimit të bujqësisë për përmirësimin dhe forcimin e statistikave të Bujqësisë.**

Situata aktuale (problemet kryesore), justifikimi i nevojave për projekte bazuar në sfidat për çdo sektor:

Bujqësia është një sektor dominant në ekonominë shqiptare, duke kontribuar me 25-30% në PBB. Regjistrimi i përgjithshëm i njësive bujqësore në 1998 bëri të mundur për INSTAT-in të krijonte një përmbledhje të situatës për kohën. Megjithatë mungesa e aktiviteteve të vazhdueshme statistikore rezultoi në mungesë të rezultateve për të matur kështu zhvillimin. Për të kompletuar aktivitetin e

<sup>1</sup> Kostot e regjistrimeve të përgjithshme nuk janë përfshirë në koston totale të PSZ

rëndësishëm të regjistrimit, do të jetë e nevojshme që INSTAT të përpilojë një regjistër të përditësuar të njësive ekonomike bujqësore për realizimet e mëtejshme të vrojtimit me zgjedhje në këtë fushë; si rezultat i mungesës së burimeve njerëzore dhe fondeve të nevojshme, këto aktivitete janë arritur në mënyrë sipërfaqësore dhe të pamjaftueshme. Situata aktuale e bujqësisë mund të përshkruhet si më poshtë:

1. informacion i pamjaftueshëm i pronave me strukturë bujqësore
2. informacion i pamjaftueshëm për prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve shtazore dhe bujqësore
3. mungesë informacioni për sa i përket ndryshimeve periodike në kokë bagëti

### **Objektiva të përgjithshme / qëllimi i projektit**

Përgatitja e një regjistri të përditësuar të bujqësisë në mënyrë që të prodhohen statistika të besueshme mbi bujqësinë në linjë edhe me kërkesat e BE të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e sistemit të Llogarive Kombëtare në Shqipëri.

### **Objektiva të tjera që mund të arrihen në zhvillimin e këtij aktiviteti janë si vijon:**

1. Ngritja e një Regjistri të Njësive Ekonomike Bujqësore, duke i ndarë në bazë të kategorive të fermave ose Njësive Ekonomike Bujqësore
2. Krijimi i Mostrës së Vrojtimit në Bujqësi dhe Blegtori
3. Krijimi i një lidhjeje mes koordinimit të të dhënave ndërmjet regjistrimit dhe vrojtimit të tjera

### **Rezultatet e pritshme**

1. Një regjistër i përditësuar i agrokulturës për të gjithë njësitë e agrikulturës që veprojnë në Shqipëri si edhe të vjeljeve të kultivuara, bagëti, pylltarisë, vjeljeve të permanente
2. Shifër vjetore e outputit total bujqësor me ndarje të detajuar rajonale
3. Shifra vjetore për punësimin bujqësor me ndarje të detajuar rajonale
4. Një sampling i detajuar për të ndërmarrë anketa statistikore për bujqësinë dhe pylltarinë

### **Institucionet përfituese / ose institucione të përfshira në zbatimin e projektit**

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, (Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave), INSTAT.

### **Aktivitetet kryesore dhe llojet e asistencës / inputet e kërkuara**

1. Hartimi dhe aprovimi i ligjit specifik për zhvillimin e regjistrimit të Bujqësisë, i përfshirë tashmë në ligjin e ri për statistikat
2. Ngritja e sistemit të kartografisë i cili do të shërbejë për identifikimin më të mirë të njësive bujqësore

3. Përdorimi i informacionit nga burimet ekzistuese për identifikimin më të mirë të njësive në zonat rurale
4. Sigurimi i burimeve financiare për hartimin dhe zbatimin e regjistrimit ekonomik
5. Ngritja e njësive të projektit për të siguruar zbatimin e projektit të regjistrimit të bujqësisë

#### *Kostot e përafërta*

Kosto totale 1,5 milion euro, kontribut i donatorëve

### **B.3 Zhvillimi i regjistrimit të popullsisë në 2011 në Shqipëri.**

Situata aktuale (problemet kryesore), justifikimi i nevojave për projekte bazuar në sfidat për çdo sektor:

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Shqipëri është zhvilluar në Prill të vitit 2001. Që prej asaj kohe, kushtet në vend kanë ndryshuar si pasojë e zhvendosjes së popullatës. Sot, nuk ka më të dhëna të vlefshme dhe të besueshme për sa i përket madhësisë, strukturës dhe shpërndarjes në terren të popullatës.

Regjistrimi i ri i popullsisë është i nevojshëm dhe i konsideruar gjithmonë si prioritet kombëtar nga Qeveria Shqiptare. Është mbi të gjitha i rëndësishëm për përcaktimin e qëllimeve ekonomike dhe shoqërore dhe planet e zhvillimit në nivel kombëtar dhe lokal ashtu si edhe për projekte bashkëpunimi dy dhe shumëpalëshe.

#### **Objektiva të përgjithshme / qëllimi i projektit**

Për të dhënë një kuadër më të përditësuar të realitetit shoqëror dhe demografik të vendit sa më afër standardeve statistikore Europiane dhe t'i ofrojë Qeverisë të dhëna statistikore të përshtatshme me qeverisjen kombëtare dhe monitorimin e reformave.

#### **Objektiva të tjera për t'u arritur nëpërmjet regjistrimit të popullsisë janë**

- Të ndihmojë Qeverinë për planifikimin dhe alokimin e burimeve sipas shpërndarjes së popullsisë
- Një investim afat-gjatë në të gjithë sistemin statistikor të vendit në termat e ngritjes së kapacitetit institucional
- Ofrimi i informacionit bazë institucioneve të tjera qëndrore në mënyrë që t'i asistojë ato në përcaktimin e strategjive të tyre
- Përgjigje më e mirë kundrejt nevojave të përdoruesve
- Statistika të krahasueshme me standartet Europiane dhe ndërkombëtare

### **Rezultatet e pritshme**

- Matja e popullsisë në Shqipëri
- Matja e numrit të familjeve
- Përlllogaritja e të gjithë treguesve demografikë, socialë dhe ekonomikë

### **Institucionet përfituese / ose institucione të përfshira në zbatimin e projektit**

INSTAT dhe Ministritë e linjës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

### **Aktivitetet kryesore dhe llojet e asistencës / inputet e kërkuara**

- Manaxhimi dhe përgatitja e regjistrimit
- Zhvillimi i regjistrimit
- Veprimet pas regjistrimit

### *Kostot e përafërta*

Kosto totale e propozuar 10 milion euro, kontribut i donatorëve

### C. Përmirësime të mëtejshme të sektorëve të statistikave primare

**Statistikat sociale**, do të përmirësohen në mënyrë të ndjeshme me përfshirjen e vrojtimeve statistikore pranë familjeve (anketa e forcave të punës dhe anketa e buxhetit të familjeve) në mënyrë periodike në programin 5 vjeçar të statistikave zyrtare.

**Statistikat e arsimit**, përmbushen nga burime administrative në konformitet me klasifikimet dhe standartet ndërkombëtare. Do të zhvillohet regjistrimi i shkollave për të mbuluar kapacitetet e arsimit primar dhe sekondar për sa i përket ndërtesave, kompjuterave dhe pajisjeve të tjera.

**Statistikat e Shëndetit**, po përballen me probleme të cilësisë së raportimit të eventeve jetësore dhe shkaqeve të vdekjeve. Kapaciteti për mbledhjen e të dhënave në sektorin e shëndetësisë duhet të rritet. Si rrjedhim, klasifikimi ndërkombëtar, ICD-10 duhet të zbatohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 2010.

**Statistikat e migrimit**, duhet ndërtuar sistemi i treguesve statistikorë të cilët aktualisht mungojnë dhe për këtë qëllim do të shfrytëzohet eksperiencia statistikore e përparuar e vendeve fqinje si Italia, Greqia dhe disa vende të tjera. Ngritja e këtij sistemi treguesish do të ndikojë jo vetëm në zgjerimin e informacionit statistikor por dhe në plotësimin më mirë të kërkesave të përdoruesve për statistikat e migrimit, aq shumë të munguara deri më sot.

**Statistikat e bujqësisë**, regjistrimi i ardhshëm i bujqësisë do të shërbejë si bazë për statistikat e bujqësisë. Ndërtimi i këtij regjistri si output-i kryesor i regjistrimit të bujqësisë, merr një rëndësi të veçantë në drejtim të përmirësimeve cilësore metodike të statistikave të bujqësisë dhe kjo nëpërmjet organizimit të anketave të llojeve të ndryshme pranë njësive bujqësore. Përmirësimi i statistikave bujqësore do të sjellë impakt pozitiv të ndjeshëm në përmirësimin cilësor të vlerësimit të PBB për sektorin e bujqësisë. Aktualisht është planifikuar një fond i caktuar për ndërmarrjen e regjistrimit të përgjithshëm të bujqësisë **por nuk ka fonde të parashikuara për kryerjen e anketave statistikore.**

**Statistikat e mjedisit**, janë për momentin nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Duhet të zhvillohet një bashkëpunim më i afërt dhe harmonizim i statistikave me standartet Europiane.

**D. Burimet e nevojshme**

## Burimet e nevojshme

Fusha të ndryshme të statistikave duhet të kenë burime shtesë. Në INSTAT në sektorin e Llogarive Kombëtare ka 9 persona. Në vende me madhësi të krahasueshme të Europës Perëndimore (sipas numrit të popullsisë) për këtë sektor punojnë rreth 30- 40 persona.

Realizimi i objektivave të përshkruara më sipër kërkon burime shtesë të personelit jo vetëm të statistikave makroekonomike (llogarive kombëtare) por edhe të personelit që prodhon statistika parësore.

Në vijim po prezantojmë parashikimet për shtesa në personel dhe mjete financiare të nevojshme me qëllim realizimin e objektivave për zhvillimin e statistikave makro dhe parësore.

Tab.2. Numri i nevojshëm i punonjësve të rinj në INSTAT në lloje të ndryshme të prodhimit shtesë për periudhën 2007 -2011

	2006 Ekzistuese	2007	2008	2009	2010	2011
<b>Statistikat ekonomike</b>						
Llogaritë Kombëtare	9	+2	+1	+1	+2	+2
Statistika paresore	24	+2	+2	+4	+4	+4
Adminisrata			+1			
<b>Gjithsej</b>		<b>+4</b>	<b>+4</b>	<b>+5</b>	<b>+6</b>	<b>+25</b>

Tabela e aktiviteteve statistikore të reja sipas viteve

Aktivitetet Statistikore të reja	2007	2008	2009	2010	2011
Anketa e forcave të punës (AFP)				x	x
Anketa B.F		x	x	x	x
Anketa e OJF		x			x
Anketa për produktet		x	x	x	x
Anketa për shërbimet		x	x	x	x
<b>Gjithsej (1)</b>		<b>4</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
Aktivitete për përmirësime të treguesve egzistues	x	x	x	x	x

Tabela e kostos për aktivitetet statistikore të reja

Aktivitetet Statistikore të reja	2007	2008	2009	2010	2011
Anketa e forcave të punës(AFP)				13,663	14,210
Anketa B.F		18,000	19,080	20,225	21,438
Anketa e OJF		500			600
Anketë për produktet		5,000	5,300	5,618	5,955
Anketë për shërbimet		2,000	2,120	2,247	2,382
Gjithsej (1)		25,500	26,500	41,753	44,585
Kosto për përmirësime të treguesve egzistues specialistë shtesë	1,372	2,744	3,430	4,116	4,116
Gjithsej (2)	1,372	2,744	3,430	4,116	4,116
Gjithsej 1+2	1,372	28,244	29,930	45,869	48,701